



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 135

Tiranë – E Enjte, 28 Gusht 2014

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 93/2014 datë 24.7.2014	Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara....	6159
Ligj nr. 94/2014 datë 24.7.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar	6164
Ligj nr. 106/2014 datë 31.7.2014	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 222, datë 4.2.2010, “Për miratimin e kontratës së lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “EUROCOPTER” për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh”, të ndryshuar.....	6166
Ligj nr. 109/2014 datë 31.7.2014	Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për bypass-in e Vlorës.....	6170
Ligj nr. 110/2014 datë 31.7.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe asistencës teknike (grant) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për pjesëmarrje në financimin e projektit të mikrofinancës në Shqipëri.....	6201
Ligj nr. 111/2014 datë 31.7.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administratore e fondeve grant të siguruar nga qeveri të ndryshme, nën Fondin e Përbashkët Europian të Ballkanit Perëndimor, dhe BERZH, nën fondin e aksionarëve të veçantë të BERZH-it, për mbikëqyrjen e projektit të rrugëve dytësore dhe lokale në Shqipëri.....	6214
Ligj nr. 112/2014 datë 31.7.2014	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011 për projektin “Programi i mbrojtjes mjedisore të liqenit të Shkodrës”.....	6222
Ligj nr. 113/2014 datë 31.7.2014	Për ratifikimin e dokumenteve ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e zhvillimit të rrugëve bashkiake të Tiranës.....	6224

Ligj nr. 114/2014 datë 31.7.2014	Për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen me mirëkuptim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, A. S.....	6225
Vendim i KM nr. 543, datë 19.8.2014	Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 542, datë 15.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Irakut, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit”, si dhe për një ndryshim në vendimin nr. 987, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për kontributin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për qeverinë afgane, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit”.....	6261
Vendim i KM nr. 545, datë 22.8.2014	Për lirim nga detyra.....	6262
Vendim i KM nr. 546, datë 22.8.2014	Për emërim në detyrë.....	6262



LIGJ
Nr. 93/2014

PËR PËRFSHIRJEN DHE
AKSESUESHMËRINË E PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i këtij ligji janë:

a) përcaktimi i të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët;

b) përcaktimet për garantimin e jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët;

c) përcaktimet për mënyrën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, nevojave për mbështetje të personave me aftësi të kufizuara dhe mënyrat se si do të sigurohet kjo mbështetje.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;

b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara,

me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.

2. “Ndhmësi personal” është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme.

3. “Pengesat” nënkupton:

a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;

b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar;

c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;

ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacionin dhe politika.

4. “Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit, njëlloj si të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

5. “Mjetet ndihmëse” është një pajisje ose një sistem produktesh që mund të modifikohet ose të përshtatet dhe të përdoret për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara për kapërcimin e pengesave dhe për të përmirësuar mundësitë e tyre për pjesëmarrje në mënyrë të barabartë.

6. “Mohim i përshtatjes së arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

7. “Organizatë e personave me aftësi të kufizuara” është çdo organizatë jofitimprurëse, ku personat me



aftësi të kufizuara ose prindërit e tyre kanë shumicën e cilësuar në vendimmarrje.

8. “Organizatë për personat me aftësi të kufizuara” është çdo organizatë jofitimprurëse, që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara dhe/ose kryen aktivitete në mbrojtje të interesave të këtyre personave e të familjeve të tyre.

9. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

10. “Përfshirje” është pjesëmarrja efikase dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona.

11. “Përshtatje e arsyeshme” është modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, atëherë kur është e nevojshme, pa vendosur barrë të tepruar, për t’u garantuar personave me aftësi të kufizuara gëzimin ose ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 4 Parimet

Parimet bazë të këtij ligji janë:

a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;

b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta;

c) autonomia e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes së personave me aftësi të kufizuara;

ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimit të pengesave të të gjitha llojeve;

d) përfshirja, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e duhur dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës;

dh) pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara;

e) qasja në dy drejtime, për të integruar në maksimum të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e zakonshëm dhe për t’i kufizuar në minimum çështjet që duhen trajtuar më vete;

ë) realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerr masa për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

KREU II JETESA E PAVARUR

Neni 5 Jetesa e pavarur

1. Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare.

2. Politikat shtetërore mbështetnin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:

a) në strehim të përshtatshëm dhe të jetojnë ku dhe me kë të dëshirojnë;

b) në shkollat e zakonshme dhe të studiojnë në shkollën për të cilën dëshirojnë;

c) në një treg gjithëpërfshirës të punësimit;

ç) në qendra kulturore, sportive dhe qendra të tjera publike;

d) në shërbime shoqërore;

dh) në qendra aftësimi dhe rehabilitimi;

e) në shërbime shëndetësore përmes infrastrukturës së përshtatshme;

ë) në transport;

f) në komunikim dhe informacion;

g) në jetën politike dhe publike, si zgjedhës dhe të zgjedhur;

gj) në aktivitete biznesi e sipërmarrjeje.

Neni 6 Shërbimet për një jetesë të pavarur

1. Jetesa e pavarur mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë



mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen: asistenca personale, pajisjet e mjetet teknike mbështetëse, shërbimet e aksesueshmërisë, përfshirë transportin, përshtatja e arsyeshme dhe, atëherë kur është e nevojshme, vendim-marrja e mbështetur.

2. Shërbimet që mundësojnë jetesën e pavarur kanë minimalisht karakteristikat e mëposhtme:

a) fokusohen në nevojat e individit dhe në zgjedhjet e tij personale;

b) mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punës, arsimit dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë, si dhe të gjitha dëmtimet e nevojat për ndihmë që rrjedhin nga dëmtimi/aftësia e kufizuar;

c) krijohen në formën e një shërbimi kontraktual ndërmjet individit me aftësi të kufizuara dhe ofruesit të shërbimit;

ç) janë nën kontrollin e personit me aftësi të kufizuara në cilësinë e konsumatorit;

d) kanë procedura të qarta dhe transparente ofrimi;

dh) përfshijnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të dhënë udhëzime;

e) japin mundësinë për personat me aftësi të kufizuara që kërkojnë ndihmë që të mësojnë gradualisht si të japin udhëzime;

ë) synojnë zhvillimin e plotë të personalitetit të personave me aftësi të kufizuara në respekt të diversitetit.

3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Vendimmarrja e mbështetur

1. “Vendimmarrje e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.

2. Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme

personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.

3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Ndihmësi personal

1. Ndihmësi personal ofron asistencën personale në cilësinë e ndihmësit për kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara, shoqëruesit për personat e verbër, interpretuesit të gjuhës së shenjave dhe lehtësuesit në komunikim për personat me paaftësi në të folur dhe në të dëgjuar.

2. Personat me aftësi të kufizuara, kur është e nevojshme, përfitojnë formim për të mësuar se si t'i udhëzojnë ndihmësit personalë.

3. Mënyrat e përfitimit të formimit të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, përcaktohen në një udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar.

4. Mënyra e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Mjetet ndihmëse

1. Mjetet ndihmëse u sigurohen personave me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për pajisje të tilla, për të kapërcyer pengesat, bazuar kjo në vlerësimin e bërë nga komisioni, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji.

2. Sigurimi i mjeteve ndihmëse rregullohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe koordinohet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

KREU III

VLERËSIMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE NEVOJAVE PËR NDIHMË E MBËSHTETJE

Neni 10

Komisioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje

1. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar realizohet nga komisionet multidisiplinare. Komisionet bëjnë vlerësimin e gjendjes së aftësisë së kufizuar, nevojave për shërbime, mjete dhe përkujdesje, me synimin për të minimizuar pengesat e përfshirjes dhe për të rritur në maksimum autonominë dhe jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara.



2. Komisionet multidisiplinare për vlerësimin e aftësisë së kufizuar e të nevojave për ndihmë e mbështetje ngrihen dhe administrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.

3. Komisionet janë të pavarura në vlerësimin dhe në punën e tyre. Ky vlerësim bëhet bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar për Funkcionimin, Aftësitë e Kufizuara dhe Shëndetin (ICF) të Organizatës Botërore të Shëndetit.

4. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, nëpërmjet strukturave të saj, kryen:

a) kontrollin e zbatimit të rregullave dhe procedurave të veprimtarisë së komisionit;

b) bashkërendimin e punës me ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë për të realizuar trajnimin e anëtarëve të komisioneve e të personelit mbështetës për metodat bashkëkohore të vlerësimit dhe për mjetet mbështetëse që disponohen.

5. Ngritja, administrimi, procedurat e vlerësimit, organizimi e funksionimi i komisionit dhe ankimet e vendimeve rregullohen me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

KREU IV

FINANCIMI I AKSESUESHMËRISË

Neni 11

Financimi i aksesueshmërisë

1. Nevojat për asistencë dhe mbështetje, në kuptim të pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji, mbështeten nga Buxheti i Shtetit. Planifikimi i fondeve të nevojshme për këtë qëllim është kompetencë e ministrisë përgjegjëse në koordinim me ministrinë e linjës për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe bazohet në udhëzime të marra nga Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

2. Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, marrin gradualisht masat për sigurimin e fondeve të nevojshme për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike.

3. Masat për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore në ofrimin e shërbimeve publike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

INSTITUCIONET

Neni 12

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

1. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e kufizuar është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit.

2. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar (KKAK) kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje të tij 17 anëtarë, nga të cilët 7 anëtarë janë individë me aftësi të kufizuara, 5 përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe 2 të organizatave për personat me aftësi të kufizuara. Ata emërohen nga Kryeministri me propozim të gjithë organizatave dhe lirohen me urdhër të Kryeministrit. Përzgjedhja e tyre bëhet duke i kushtuar vëmendjen e duhur gjithëpërfshirjes së kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, moshës dhe gjinisë.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës.

4. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, në ushtrimin e detyrave të tij mbështetet nga sekretariati teknik i aftësisë së kufizuar pranë ministrisë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar.

5. Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar përcaktohen në rregulloren e këtij këshilli, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 13

Detyrat e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar ka këto detyra:

a) këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;

b) i propozon ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, programet kryesore shtetërore për të për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;

c) vlerëson gjendjen konkrete të garantimit të aksesueshmërinë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, duke nxjerrë udhëzime dhe duke dhënë rekomandime të posaçme për ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;

ç) analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;



d) rekomandon shërbime dhe programe që janë specifikisht të orientuara për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;

dh) shërben si organ konsultimi për çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e komisioneve për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje;

e) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;

ë) jep rekomandime për ndërtimin e mekanizmave të mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe të mbikëqyrë mbledhjen dhe përpunimin e tyre.

Neni 14

Bashkëndimi i veprimtarive për problemet e personave me aftësi të kufizuara

1. Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përmbushjes së funksionit të tij. Për këtë qëllim, në çdo ministri, me urdhër të ministrit përkatës, caktohet një nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar. Organet e qeverisjes vendore emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të aftësisë së kufizuar, pranë tyre.

2. Nëpunës që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar është punonjësi i administratës publike, qendrore apo vendore, i cili ka formim dhe njohuri të posaçme në fushën e aftësisë së kufizuar dhe ka për detyrë të monitorojë që politikat e programet hartohen dhe zbatohen në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për aksesueshmërinë dhe përfshirjen, duke siguruar mundësi të barabarta për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 15

Organizatat jofitimprurëse me të drejtë për t'u konsultuar

1. Subjektet, që marrin pjesë në procesin e konsultimit publik, për çështjet e aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik, janë:

- a) individit me aftësi të kufizuara;
- b) organizatat e personave me aftësi të kufizuara;
- c) organizatat për personat me aftësi të kufizuara;
- ç) organizatat që përfaqësohen në Këshillin

Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, në kuptim të nenit 13 të këtij ligji.

2. Çdo organizatë jofitimprurëse, që pretendon se i është mohuar e drejta për t'u konsultuar apo se është përjashtuar pa të drejtë nga proceset konsultuese, ka të drejtë të ankohe, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik.

Neni 16

Monitorimi

1. Avokati i Popullit, monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 8328, datë 30.4.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve", të ndryshuar.

2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

KREU VI

MBËSHTETJA PËR ZBATIM

Neni 17

Të dhënat dhe statistikat

1. INSTAT-i dhe strukturat përgjegjëse mbledhin të dhëna të përshtatshme statistikore dhe kërkimore, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave, për të mundësuar politika dhe planifikime të aksesueshme dhe përfshirëse.

2. Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, mbledhin të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave ku ato operojnë. Llojshmëria e periodiciteti i mbledhjes së të dhënave dhe mënyra e raportimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Imazhi publik dhe ndërgjegjësimi

1. Qeveria nxit një model bashkëkohor të aftësive të kufizuara dhe të dëmtimit, duke rritur ndërgjegjësimin për barazinë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht duke theksuar mjetet për mbështetje dhe ndihmë për të siguruar mundësi dhe kushte të barabarta me të tjerët.



2. Media publike dhe private nxit përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet imazheve që theksojnë mosdiskriminimin, autonominë e personave me aftësi të kufizuara dhe sigurojnë mundësitë që këta persona të flasin vetë për veten e tyre.

3. Qeveria rrit ndërgjegjësimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e tyre në shoqëri me fushata ndërgjegjësuere.

Neni 19

Formatet e aksesueshme

Ky ligj, ligje të tjera dhe aktet nënligjore përkatëse, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht me të drejtat dhe përfitimet e posaçme të personave me aftësi të kufizuar është i disponueshëm në format të aksesueshëm, i cili është printimi dhe botimi i teksteve në Braille, printim me shkronjë të madhe, në gjuhë të thjeshtuar, të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 20

Ndryshimet në legjislacion

Bazuar në këtë ligj, institucionet përgjegjëse ndërmarrin ndryshime graduale në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të përshtatur formulimin, termat, synimin dhe qëllimin me modelin dhe imazhin bashkëkohor të dëmtimit dhe aftësisë së kufizuar, veçanërisht me autonominë dhe të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për jetesë të pavarur dhe me përfshirjen e tyre në të gjitha sferat e jetës, në kushte të barabarta me të tjerët.

Neni 21

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 13, pika 3, dhe 17, pika 2, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, pika 4, dhe 11, pika 3, brenda 6 muajve, si dhe aktet nënligjore në zbatim të neneve 6, pika 3, 7, pika 3, 10, pika 5, dhe 20, brenda 24 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

2. Ngarkohet ministri që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të pikës 3, të nenit 8, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 22 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.7.2014

KRYETARI
Ilir Meta

LIGJ Nr. 94/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9831, DATË 12.11.2007, “PËR DËMSPËRBLIMIN E ISH TË DËNUARVE POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 17, 44, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 12 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Në bazë të buxhetit vjetor, të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist, do të ndahet, në mënyrë proporcionale, në një raport prej 70 për qind për të gjitha kategorinë e subjekteve përfituese parësore, të përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni, dhe 30 për qind për trashëgimtarët e ish të dënuarve, që nuk bëjnë pjesë në këtë kategori, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe jo më i madh se 1 000 000 (një milion) lekë.

Me shlyerjen përfundimtare të dëmshpërblimit të subjekteve përfituese parësore, të përcaktuara sipas këtij neni, i gjithë buxheti vjetor kalon për dëmshpërblimin e trashëgimtarëve të ish të dënuarve politikë.”.

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:



“Shpërndarja e dëmshpërblimit për kategorinë e subjekteve përfituese parësore, për të njëjtin këst, do të kryhet sipas kësaj radhe:

a) ish të dënuarat politike gra, që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës;

b) ish të dënuarit politikë, që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshën mbi 75 vjeç me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

c) ish të dënuarit politikë, të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda, sipas përcaktimit të aktit nënligjor të posaçëm;

ç) ish të dënuarit politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës, të cilët, pavarësisht nga mosha, kanë pasardhës të radhës së parë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

d) ish të dënuarit politikë që nuk jetojnë dhe që kanë trashëgimtarë të radhës së parë, të cilët janë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

dh) ish të dënuarit politikë që jetojnë, në momentin e dhënies së pagesës, dhe që kanë moshë nën 75 vjeç me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Me kryerjen e pagesës, për të gjitha subjektet parësore, brenda kështit më të ulët, fillon pagesa e kështit pasardhës e kështu me radhë.”

Neni 2

Në nenin 13, paragrafi i parë shfuqizohet.

Neni 3

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Tërheqja e dëmshpërblimit

Struktura përgjegjëse për pagesën e dëmshpërblimeve të ish të dënuarve politikë në Ministrinë e Financave publikon, në mënyrë periodike, në faqen zyrtare, listat e dosjeve të gatshme për pagesë dhe bën njoftimin për të gjitha subjektet përfituese, pjesë e listës, nëpërmjet shërbimit postar, njoftimit me mjete të komunikimit elektronik (e-mail) dhe medias publike.

Brenda një afati 3-mujor nga data e publikimit të listës, të gjithë ish të përndjekurit, të cilët janë pjesë e saj, duhet të dorëzojnë në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Financave dokumentet e parashikuara në aktet nënligjore që janë nxjerrë në zbatim të ligjit.

Kur një ish i dënuar politik ose trashëgimtari /trashëgimtarët e ish të dënuarit politik nuk dorëzon dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të parashikuar në paragrafin e mësipërm, ai/ajo njoftohet lidhur me

përfundimin e këtij afati dhe i jepet një afat shtesë deri në 30 ditë. Në rast se dokumentacioni i kërkuar nuk dorëzohet edhe pas kalimit të afatit shtesë (30 ditë), pagesa i kalon personave që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore, të cilat, në përputhje me ligjin, kanë dorëzuar dokumentet e duhura dhe janë të gatshme për pagesë.

Kur një ish i dënuar politik ose trashëgimtari /trashëgimtarët e ish të dënuarit politik refuzon të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të parashikuara si më sipër, forma e refuzimit duhet të jetë me shkrim. Edhe në këtë rast, pagesa i kalon personave që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore, të cilat, në përputhje me ligjin, kanë dorëzuar dokumentet e duhura dhe janë të gatshme për pagesë.

Personat, të cilët nuk dëmshpërblehen, për shkak të mosplotësimit të dokumenteve, gëzojnë të drejtën për të marrë këstin e kësaj pagese në fazën tjetër, por jo më vonë se tre vjet pas publikimit të emrit për herë të parë në faqen zyrtare. Me kalimin e kësaj periudhe (3 vjet), personi që nuk ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, humbet të drejtën e dëmshpërblimit.”

Neni 4

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Forma e pagesës

Forma e pagesës përcaktohet me udhëzim të Ministrisë së Financave.”

Neni 5

Neni 16 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 32, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë: “Këshilli i Ministrave, brenda vitit 2014, miraton afatet dhe skemën e shpërndarjes së fondeve.”

Neni 7

Neni 33 shfuqizohet.

Neni 8

Aktet nënligjore

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, udhëzimin sipas përcaktimeve të bëra në nenin 4, të këtij ligji.



Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.7.2014

KRYETARI
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 106/2014

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 222, DATË 4.2.2010, “PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “EUROCOPTER” PËR FURNIZIMIN ME 5 HELIKOPTERË TË MESËM SHUMËROLËSH”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratimin e disa ndryshimeve në kontratën e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë “EUROCOPTER” për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh, të miratuar me ligjin nr. 10 222, datë 4.2.2010, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8690, datë 22.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

AMENDIMI I KONTRATËS NR. 12/2009 NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE EUROCOPTER PËR FURNIZIMIN E PESË (5) HELIKOPTERËVE AS532 AL COUGAR DHE PAJISJEVE SHOQËRUESE NËNSHKRUAR MË 17 DHJETOR 2009

Ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes (MD):

Rruga e Dibrës

2423, Tiranë, Shqipëri

E-mail: mirela.roshi@mod.gov.al

Tel: ++ 355 4 225 5232

Faks: ++ 355 4 225 5226

Dhe përfaqësuar rregullisht nga znj. Mimi Kodheli, Ministre e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë (më poshtë quhet “Blerësi”)

dhe

Airbus Helicopters

(riemërtim i Eurocopter-it nga data 7 janar 2014)

Me seli në:

Aéroport International de Marseille - Provence

13725 Marignane Cedex - France

E përfaqësuar rregullisht nga

Z. Laurent Visa, Menaxher i Lartë i Shitjeve

(më poshtë quhet “Shitësi”)

Transferuesi dhe Kontraktuesi quhen “Pala” ose “Palët”

Ndërsa:

Palët nënshkruan një kontratë më 17 dhjetor 2009 në lidhje me blerjen nga Blerësi dhe dorëzimin nga Shitësi të 5 (pesë) helikopterëve AS532 AL Cougar dhe pajisjeve të tyre shoqëruese (“Kontrata”).

Palët bien dakord të ndryshojnë dispozitat e Kontratës (duke përfshirë të gjitha anekset, të cilat janë pjesë përbërëse e saj) sipas paragrafit të parë të nenit 6.1 të Kontratës, i cili parashikon se çdo ndryshim i Kontratës do të jetë i vlefshëm vetëm nëse Palët bien dakord me shkrim.

Pas rrëzimit të helikopterit të parë (“Helikopteri i Parë”) pas transferimit të pronësisë nga Shitësi te Blerësi gjatë fluturimit testues më 25 korrik 2012 (“Aksidenti”), Palët bien bashkërisht dakord të zëvendësojnë helikopterin e parë, siç përcaktohet sipas Kontratës dhe/ose në ndonjë prej ndryshimeve të saj të mëparshme, me 2 (dy) helikopterë të rinj EC 145 (“2 helikopterët EC 145”) dhe të shoqëruar me paketën mbështetëse, sipas termave dhe kushteve të parashikuara sipas këtij amendimi.



Dispozitat e këtij amendimi të ri kanë përparësi ndaj nenit(ve) të Kontratës dhe të amendimeve të mëparshme, sipas rastit.

Kështu duke pasur parasysh sa më sipër, ndërmjet palëve bihet dakord si më poshtë:

Neni 1 Amendimet

Kontrata ndryshohet në mënyrën e mëposhtme:

1.1 Të përgjithshme

1.1.1 Neni 1.4.1 ndryshohet si më poshtë:

“Helikopterët” do të thotë 4 (katër) helikopterë AS532 AL Cougar dhe 2 (dy) helikopterë EC 145 në konfigurimin SAR të përcaktuar në konfigurimin teknik, aneksi 1A “Konfigurimi helikopterët AS532 AL Cougar” dhe konfigurimi teknik aneksi 1B “Konfigurimi “Helikopterët EC 145””.

1.1.2 Çdo dhe të gjitha referencat sipas Kontratës së “Pesë (5) Helikopterë AS532 AL Cougars” ose “Helikopterë Multi Role 5 AS 532 AL” do të zëvendësohen me termin “4 (katër) helikopterët AS532 AL Cougars dhe 2 (dy) Helikopterët EC 145”.

1.1.3 Çdo dhe të gjitha referencat sipas Kontratës dhe/ose ndonjë nga ndryshimet e saj të mëparshme të “Helikopter i parë” ose “Helikopteri 1-rë” zëvendësohet me 2 (dy) Helikopterë EC 145”.

1.1.4 Çdo dhe të gjitha referencat sipas Kontratës dhe/ose ndonjë nga ndryshimet e saj të mëparshme të “Helikopter i dytë” ose “Helikopter 2-të” zëvendësohet me “Helikopter AS532 AL Cougar të konfiguruar CSAR”.

1.1.5 Çdo dhe të gjitha referencat sipas Kontratës dhe/ose ndonjë nga ndryshimet e saj të mëparshme të “Helikopter i Tretë” ose “Helikopter 3-të” zëvendësohet me “Helikopter AS532 AL Cougar” të konfiguruar MEDEVAC”.

1.1.6 Çdo dhe të gjitha referencat sipas Kontratës dhe/ose ndonjë nga ndryshimet e saj të mëparshme të “Helikopter i katërt” ose “Helikopter 4-të” zëvendësohet me “Helikopter AS532 AL Cougar të konfiguruar TTH”.

1.1.7 Çdo dhe të gjitha referencat sipas Kontratës dhe/ose ndonjë nga ndryshimet e saj të mëparshme të “Helikopter i pestë” ose “Helikopter 5-të” zëvendësohet me “Helikopter AS532 AL “Cougar, të konfiguruar TTH”.

1.1.8 Palët bien dakord që konfigurimi teknik, aneksi 1 “Konfigurimi i helikopterit” sipas Kontratës do të referohet sipas këtij amendamenti si konfigurimi teknik aneksi 1A “Konfigurimi i helikopterëve AS532AL COUGAR”.

1.1.9 Palët bien dakord për të shtuar aneksin 1/B mbi konfigurimin e helikopterëve EC 145. Konfigurimi teknik aneksi 1B “Konfigurimi i helikopterëve EC 145” do të bashkëlidhet në këtë amendim (shtojca 1 e këtij amendimi).

1.1.10 Palët bien dakord për të shtuar aneksin 1/C mbi Paketën Mbështetëse të Helikopterëve EC 145. Paketa mbështetëse aneksi 1/C “Paketa Mbështetëse EC 145” do të bashkëlidhet në këtë amendim (shtojca 2 e këtij amendimi).

1.1.11 Palët bien dakord që aneksi 2, Modeli i Deklaratës së Përputhshmërisë ose Certifikata e Përputhshmërisë do të zbatohen vetëm për 4 (katër) helikopterë AS532 AL COUGAR.

1.1.12 Palët bien dakord për të shtuar aneksin 2B mbi Modelin e Deklaratës së Përputhshmërisë ose Certifikata e Përputhshmërisë vetëm për helikopterët EC 145. Aneksi 2B Model i Deklaratës së Përputhshmërisë ose Certifikata e Përputhshmërisë për helikopterët EC 145 do të bashkëlidhen në këtë amendament (shtojca 3 e këtij amendamenti).

1.1.13 Palët bien dakord që aneksi 3 Modeli i Protokollit të Pranimit dhe aneksi 4 Modeli i Protokollit të Pranimit dhe Transferimit të Pronësisë do të zbatohen vetëm për 4 (katër) helikopterët AS532 AL COUGAR.

1.1.14 Palët bien dakord për të shtuar në aneksin 3B mbi Modelin e Protokollit të Pranimit dhe Transferimit të Pronësisë vetëm për helikopterët EC145. Aneksi 3B Modeli i Protokollit të Pranimit dhe Transferimit të Pronësisë për helikopterët EC145 do të bashkëlidhen në këtë amendament (shtojca 4 e këtij amendamenti). Procedurat e pranimit të dy helikopterëve EC145 do të kryhen në Nodauworth, Gjermani.

1.1.15 Palët bien dakord të ndryshojnë deklaratën e uljes së parashikuar në aneksin 8 të Kontratës. Aneksi 8 deklaratë e uljes, e rishikuar dhe e ndryshuar, i bashkëlidhet këtij amendimi (shtojca 5 e amendimit).

1.1.16 Palët bien dakord që aneksi 9 “Kushtet e garancisë së motorit” sipas Kontratës, i referohen vetëm kushteve të garancisë së motorit AS532 AL Cougars dhe emërtimi i këtij aneksi ndryshohet në (Aneksi 9, Kushtet e Garancisë së Motorit A AS532 AL Cougars).



1.1.17 Palët bien dakord për të shtuar aneksin 9 B të kushtet e garancisë së motorit për helikopterët EC 145. Aneksi 9B (Kushtet e Garancisë së Motorit EC 145”) sipas Kontratës i bashkëngjitet këtij amendimi (shtojca 6 e këtij amendimi).

1.2 Çmimet
Tabela nën nenin 9.1 ndryshohet në mënyrën e mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi DDU në euro
1	4 (katër) helikopterët multi role AS532 AL me konfigurimin që përshkruhet në volumn 3: Aneksi 17 propozim tregtar i Eurocopter + Garanci për 500 orë fluturimi ose 12 muaj për AS532 AL ose 12 muaj për helikopterin dhe pajisjet opsionale, cilado të skadojë e para 2 (dy) helikopterë EC 145 sipas konfigurimit të detajuar sipas aneksit 1B.	4 (katër) 2 (dy)	69 444 093 €
2	Nivelet I dhe II të pjesëve të këmbimit dhe veglave të mirëmbajtjes	1 komplet për AS532AL 1 komplet për EC145	2 259 776 €
3	Çmimi i plotë AS 532AL, Kits 1X SAR Kit, 1X MEDEVAC Kit, 2X Troop Transport Kit	4	6 299 321 €
4	Çmimi për trajnimin e pilotit (10 pilotë për AS532AL dhe 4 pilotë për EC145)	14	483 300 €
5	Çmimi për trajnimin e pilotit instruktor AS32AL (2 pilotë)	2	47 798 €
6	Çmimi i trajnimit të teknikëve (5 teknikë për AS532AL dhe 4 teknikë për EC145)	9	75 000 €
7	Çmimi për trajnimin e teknikëve elektrikë (2 teknikë elektrikë për AS532 AL dhe 2 teknikë elektrikë për EC145)	4	24 000 €
	Çmimi i plotë		78 633 288 €

1.3 Termat e pagesës

Paragrafi 7 i “Nenit 11.1 - Të përgjithshme”, ndryshohet si më poshtë:

Një letër-kredi e katërt do të hapet me porosi të blerësit jo më vonë se 30 qershor 2014 për shumën e 4 000 000,00 (vetëm katër milionë euro) me synim mbulimin e pagesës me paraqitje për pagesën e balancës së AS532AL Cougar me konfigurim TTH2. Kjo letër-kredi do të jetë e vlefshme deri më 30 shtator 2014.

Shtohet një paragraf i ri pas paragrafit të 7-të “Nenit 11.1 - Të përgjithshme”, si më poshtë:

“Një letër-kredi e pestë do të hapet me porosi të blerësit jo më vonë se 28 shkurt 2015 për shumën e 6 344.788,00 (vetëm gjashtë milionë e treqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë euro) me synim mbulimin e pagesës me paraqitje për pagesën e balancës së 2 helikopterëve EC 145 (nenet 11.4.6 dhe 11.4.7). Kjo letër-kreditë do të jetë e vlefshme deri më 30 nëntor 2015”.

1.4 Pagesat sipas përparimit të punës

Neni i ri 11.3.3 përfshihet si më poshtë:

Një shumë prej 6.226.000,00 eurosh (vetëm gjashtë milionë e dyqind e njëzet e gjashtë mijë euro) do të paguhet nga blerësi jo më vonë se 30 nëntor 2014 me transfertë telegrafike te llogaria e shitësit që përmendet më sipër kundrejt paraqitjes së një fature tregtare në një kopje origjinale plus dy kopjeve të lësnuara nga shitësi për shumën përkatëse dhe një kopje të certifikatës së përparimit të punës”.

1.5 Pagesat e balancës

Neni 11.4.5, ndryshohet si më poshtë:

Një shumë prej 4.000,000 eurosh (vetëm katër milionë euro) është e pagueshme shitësit nëpërmjet letër-kredisë, pas uljes së helikopterit AS532 AL Cougar, në konfigurimin TTH2, në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit në Tiranë, kundrejt paraqitjes nga shitësi te sporteli i Bankës Konfirmuese të:

A. FATURËS TREGTARE NË NJË KOPJE ORIGJINALE DHE NË DY KOPJE TË LËSHUARA NGA SHITËSI

B. CERTIFIKATËS SË PËRPUTHSHMËRISË OSE DEKLARIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË NË NJË FOTOKOPJE TË LËSHUAR NGA EUROCOPTER-I PËR HELIKOPTERIN AS532 AL COUGAR NË KONFIGURIMIN TTH2.

C. PROTOKOLLIT TË PRANIMIT DHE TRANSFERTËS SË PRONËSISË TË LËSHUAR NGA EUROCOPTER-I PËR HELIKOPTERIN TTH2 COUGAR.

D. DEKLARIMIN E ULJES (“DEKLARIMI I ULJES”) NË PAJTIM ME MODELIN E BASHKË-NGJITUR NË ANEKsin 8 TË KONTRATËS.

Nenet e reja 11.4.6 dhe 11.4.7, shtohen si më poshtë:



11.4.6 Pagesa e balancës për EC 145 e parë

Një shumë prej 3,172,394,00 eurosh (vetëm tre milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër euro) është e pagueshme, shitësit nëpërmjet letër-kredisë, pas paraqitjes, pas uljes së EC 145 të parë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit në Tiranë, kundrejt paraqitjes nga shitësi te sporteli i Bankës konfirmuese të:

A. FATURËS TREGTARE NË NJË KOPJE ORIGJINALE DHE NË DY KOPJE TË LËSHUARA NGA SHITËSI.

B. CERTIFIKATËS SË PËRPUTHSHMËRISË OSE DEKLARIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË NË NJË FOTOKOPJE TË LËSHUAR NGA EUROCOPTER-I PËR EC 145 TË PARË.

C. PROTOKOLLIT TË PRANIMIT DHE TRANSFERTËS SË PRONËSISË TË LËSHUAR NGA AIRBUS EUROCOPTER-I PËR EC 145 TË PARË

D. DEKLARIMIN E ULJES (“DEKLARIMI I ULJES”) NË PAJTIM ME MODELIN E BASHKËLIDHUR NË ANEKSIN 8 TË KONTRATËS.

11.4.7 PAGESA E BALANCËS PËR EC 145 E DYTË

Një shumë prej 3,172,394.00 eurosh (vetëm tre milionë e njëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër euro) është e pagueshme, shitësit nëpërmjet letër-kredisë, pas paraqitjes, pas uljes së EC145 të dytë në Aeroportin Ndërkombëtar të Rinasit në Tiranë, kundrejt paraqitjes nga shitësi te sporteli i Bankës Konfirmuese të:

A. FATURËS TREGTARE NË NJË KOPJE ORIGJINALE DHE NË DY KOPJE TË LËSHUARA NGA SHITËSI.

B. CERTIFIKATËS SË PËRPUTHSHMËRISË OSE DEKLARIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË NË NJË FOTOKOPJE TË LËSHUAR NGA AIRBUS EUROCOPTER-I PËR EC 145 TË DYTË.

C. PROTOKOLLIT TË PRANIMIT DHE TRANSFERTËS SË PRONËSISË TË LËSHUAR NGA EUROCOPTER-I PËR EC 145 TË DYTË.

D. DEKLARIMIN E ULJES (“DEKLARIMI I ULJES”) NË PAJTIM ME MODELIN E BASHKËLIDHUR NË ANEKSIN 8 TË KONTRATËS.

1.6 Garancitë bankare

Paragrafi 1 i “Nenit 11.5.1 - Formulari i sigurisë”, ndryshohet si më poshtë:

Me qëllim që të garantohet përmbushja e pjesës së mbetur të Kontratës, një formular garancie në shumën 1.657.078,80 euro (vetëm një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e tetë euro e

tetëdhjetë cent) që përfaqëson (10% të detyrimit kontraktual të mbetur lëshohet në favor të blerësit.

Paragrafi 3 i “Nenit 11.5.1 - Formulari i sigurisë”, ndryshohet si më poshtë:

Garancia e përmbushjes hyn në fuqi nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës, e cila i njoftohet bankës menjëherë nga shitësi pas hyrjes në fuqi të këtij amendimi dhe mbetet në fuqi deri 30 ditë pas datës së fundit të dorëzimit të helikopterit të fundit ose jo më vonë se 30 nëntor 2015.

1.7 Dorëzimi

Paragrafi i mëposhtëm zëvendëson rreshtin e parë të paragrafit të katërt të nenit 12.2:

“Datat e dorëzimit të helikopterëve 2EC 145 janë TO+11 muaj dhe TO+12 muaj përkatësisht, duke filluar nga hapja e letër-kredisë së katërt.

Neni 2

Shtesë tjetër e Kontratës

2.1 Palët bien dakord që pas nënshkrimit rregullisht të këtij amendimi nga palët: i) palët bien bashkërisht dakord dhe mbeten të përkushtuara të vazhdojnë me vullnet të mirë zbatimin përfundimtar të Kontratës, në pajtim me amendimet e parashikuara në të sipas këtij amendimi; dhe ii) blerësi heq dorë nga e drejta e tij të ngrejë pretendime për dëmet, detyrimet dhe/ose humbjet kundrejt shitësit ose siguruesve të tij që rrjedhin nga ose në lidhje me Kontratën pas zëvendësimit të helikopterit të parë Cougar me 2 (dy) helikopterë të rinj EC 145.

2.2 Palët bien dakord që do të jetë ekskluzivisht e drejta e shitësit të marrë dhe të mbajë çdo shumë të arkëtueshme nga një policë sigurimi të helikopterit të parë Cougar nga siguruesit.

2.3 Palët bien dakord që çmimi total i Kontratës, i parashikuar në Kontratë, të mbetet i pacenuar dhe ai reflekton çmimin e përgjithshëm të të gjitha mallrave dhe/ose shërbimeve sipas Kontratës dhe amendimeve të saj, duke përfshirë këtë amendim.

Neni 3

Të ndryshme

Termat dhe kushtet e Kontratës (duke përfshirë amendimet e saj të mëparshme), të cilat nuk ndryshohen nga ky amendim, mbeten në fuqi.

Ky amendim është nënshkruar nga palët në 8 kopje, 4 (katër) në anglisht dhe 4 (katër) shqip (përveç anekseve të cilat janë të disponueshme vetëm në anglisht).



Në rastin e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Në dëshmi të kësaj, ky amendim është nënshkruar nga secili përfaqësues i autorizuar i palës dhe hyn në fuqi pas nënshkrimit të tij dhe ratifikimit të tij nga Parlamenti Shqiptar.

_____/_____/2014

Vendi dhe data

Për dhe në emër të Autoritetit Kontraktues

Shkëlqesia e saj, Ministria e Mbrojtjes

Mimi Kodheli

_____/_____/2014

Vendi dhe data

Për dhe në emër të Kontraktuesit

Menaxheri i lartë i shitjeve

Laurent Visa

LIGJ
Nr. 109/2014

**PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS
FINANCIARE, NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE
TË INVESTIMEVE, PËR BYPASS-IN E
VLORËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet kontrata financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për bypass-in e Vlorës, me një kredi në shumën 18 000 000 (tetëmbëdhjetë milionë) euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8691, datë 22.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Ky është vetëm dokument pune. Ai nuk është rishikuar nga shërbime të caktuar të Bankës dhe kështu të gjitha dispozitat dhe nenet që gjenden në të mund t'i nënshtrohen rishikimit dhe ndryshimit të konsiderueshëm, pa shkaktuar detyrime për Bankën. Ai i nënshtrohet gjithashtu aprovimit përfundimtar të Bankës dhe Projektit duke marrë të gjitha lejet e nevojshme.

JUOPS/SEE/LW/mo 07/04/2014

JUOPS/SEE/LW/mo 20/05/2014

JUOPS/SEE/LW/mo 30/05/2014

FI N° 82.138 (AL)

Serapis N°2012-0200

BYPASS-I I VLORËS

**KONTRATË FINANCIARE NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE
TË INVESTIMEVE**
(Vendndodhja dhe data)

Kjo kontratë lidhet ndërmjet:

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe përfaqësuar nga Ministri i Financave, Z. Shkëlqim Cani (“Huamarrësi”) nga njëra anë, dhe Bankës Europiane të Investimeve që ka selinë e saj në adresën: 100 blvd. Konrad Adenauer, Luxembourg, L-2950 Luxembourg, e përfaqësuar nga Zëvendës-presidenti, Z. Dario Scannapieco (“Banka”) nga ana tjetër,

Duke marrë në konsideratë se:

1. Huamarrësi ka deklaruar që Autoriteti Shqiptar i Rrugëve (“Autoriteti Shqiptar i Rrugëve” ose “ASHR”) nëpërmjet Ekipit të Zbatimit të Projektit secili i lidhur me Ministrinë Shqiptare të Transportit dhe Infrastrukturës (“Zbatuesi”) po ndërmerr një projekt që përbëhet nga ndërtimi i një autostrade 29 km që anashkalon qytetin e Vlorës për të përmirësuar rrjedhën e trafikut përgjatë bregut jugor të Shqipërisë, siç përshkruhet më me hollësi në përshkrimin teknik (“Përshkrimi Teknik”) të përcaktuar në skedulën A (“Projekti”).

2. Banka vlerëson se kostoja totale e Projektit (pa TVSH) është 67,600,000.00 (gjashtëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind mijë Euro), për t'u financuar, në një shumë të mjaftueshme për të mbuluar koston aktuale totale të Projektit, me një Kredi nga Banka, një Hua nga BERZH-i, grante të Instrumentit të Para-Aderimit (IPA) të Komisionit Europian dhe



fonde të veta. Kontributi i fondeve të veta është parashikuar në datën e kësaj kontrate të arrijë në 8,600,000.00 euro (tetë milionë e gjashtëqind mijë euro).

3. Me qëllim që të përmbushet plani financiar i përcaktuar në paragrafin hyrës (2), Huamarrësi i ka kërkuar Bankës një kredi. Duke pasur në konsideratë vlerësimin e kostos totale të Projektit të përcaktuar në paragrafin e mësipërm hyrës (2), Banka ka aprovuar një kredi në shumën 24,000,000 euro (njëzetekatër milionë euro). Huamarrësi dhe Banka kanë rënë dakord që Kredia (siç përcaktohet më poshtë) do të jetë 18,000,000 euro (tetëmbëdhjetë milionë euro), duke nënkuptuar se Kredia do të përdoret ekskluzivisht për të financuar komponentët e Projektit në lidhje me punimet civile të përshkruara në përshkrimin teknik.

4. Me vendimin nr. 1080/2011/BE, të ndryshuar herë pas here, Parlamenti Europian dhe Këshilli i Bashkimit Europian kanë vendosur të japin një garanci për Bankën ndaj humbjeve të shkaktuara asaj nga huat dhe garancitë e huas të dhëna nga viti 2007 deri më 2013, e shtyrë deri më 30 qershor 2014 në përputhje me këtë vendim, në pajtim me rregullat dhe procedurat e veta për projektet e zbatuara në vende të caktuara jashtë Bashkimit Europian të renditura në këtë vendim, duke përfshirë Republikën e Shqipërisë.

5. Marrëveshja kuadër që rregullon aktivitetet e Bankës në territorin e Shqipërisë e nënshkruar më 5 shkurt 1998 nga Huamarrësi dhe Banka (“Marrëveshja Kuadër”) është e zbatueshme për këtë Kontratë.

6. Duke marrë parasysh që financimi i Projektit përfshihet në objektin e funksioneve të saj dhe duke pasur parasysh deklaratimet dhe faktet e cituara në këta Paragrafë Hyrës, Banka ka vendosur të plotësojë kërkesën e Huamarrësit duke i dhënë atij një kredi në shumën 18,000,000.00 (tetëmbëdhjetë milionë euro) sipas kësaj Kontrate Financimi (“Kontrata”); me kusht që shuma e huas së Bankës të mos kalojë në asnjë rast 50% (pesëdhjetë për qind) të kostos totale të Projektit të parashikuar në paragrafin hyrës (2).

7. Huamarrësi autorizohet sipas rregullave në nënshkruajë Kontratën. Huamarrësi konfirmon statusin e preferuar të kreditorit për Bankën si një institucion financiar ndërkombëtar.

8. Huamarrësi konfirmon që Zbatuesi është tërësisht funksional dhe operacional, duke pasur të gjitha të drejtat dhe lejet e nevojshme për të përmbushur dhe zbatuar Projektin.

9. Statuti i Bankës parashikon që Banka do të sigurojë që fondet e saj përdoren në mënyrë sa të

arsyeshme që të jetë e mundur në interes të Bashkimit Europian, dhe, për pasojë termat dhe kushtet e operacioneve të huas së Bankës duhet të jenë në pajtim me politikat përkatëse të Bashkimit Europian.

10. Në pajtim me Rekomandimet e Task Forcës për Masa Financiare, që është themeluar brenda Organizatës së Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Banka u kushton vëmendje të veçantë transaksioneve dhe marrëdhënieve të saj të biznesit në ato raste kur ajo ofron financim: a) për një projekt që gjendet në një vend as nuk i zbaton në mënyrë të mjaftueshme ato rekomandime; ose b) për një huamarrës ose përfitues rezident në këtë vend.

11. Financimi i Projektit përfshin subvencione ose grante të caktuara dhe dhënia e këtyre fondeve është autorizuar rregullisht dhe ofrohet në pajtim me të gjithë legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian.

12. Banka është e mendimit që aksesimi në informacion luan një rol thelbësor në uljen e risqeve mjedisore dhe sociale, duke përfshirë shkeljet e të drejtave të njeriut, të lidhura me projektet që ajo financon dhe kështu ka vendosur Politikën e saj të Transparencës, synimi i së cilës është forcimi i përgjegjësisë së grupit të BEI-t kundrejt grupeve të saj të interesit dhe qytetarëve të Bashkimit Europian në përgjithësi.

13. Përpunimi i të dhënave personale do të kryhet nga Banka në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm të Bashkimit Europian mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e BE-së dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

Kështu, bihet dakord si më poshtë:

INTERPRETIME DHE PËRKUFIZIME

a) Interpretim

Në këtë Kontratë:

i) Referencat ndaj Neneve, Paragrafëve Hyrës, Skeduleve dhe Anekset, përveç kur parashikohen shprehimisht ndryshe, janë referenca përkatësisht ndaj neneve, paragrafëve hyrës, skeduleve dhe anekset e kësaj Kontrate.

ii) Referencat ndaj një dispozitë ligjore janë referencat ndaj asaj dispozite të ndryshuar ose rimiruar.

iii) Referencat ndaj një marrëveshjeje ose instrumenti tjetër janë referenca ndaj asaj marrëveshjeje apo instrumenti tjetër të ndryshuar, rinovuar, plotësuar, zgjeruar apo riformular.

b) Përkufizime

Në këtë Kontratë:



“Afati i Pranimit” për një njoftim është:

a) Ora 16 00 sipas orës së Luksemburgut në ditën e dorëzimit, nëse njoftimi bëhet brenda orës 14 00 sipas orës së Luksemburgut në një Ditë Pune; ose

b) Ora 11 000 sipas orës së Luksemburgut në ditën pasuese e cila është një Ditë Pune, nëse njoftimi bëhet pas orës 14 00 sipas orës së Luksemburgut në çdo ditë të tillë ose bëhet në një ditë që nuk është Ditë Pune.

“Autoriteti Shqiptar i Rrugëve” ka kuptimin e dhënë atij në paragrafin hyrës (1) dhe është themeluar në pajtim me ligjin shqiptar nr. 10164 të datës 15 tetor 2009.

“Autorizim” është një autorizim, leje, pëlqim, aprovim, vendim, licencë, përjashtim, dorëzim, noterizim apo regjistrim.

“Ditë Pune” është një ditë (e ndryshme nga e shtuna ose e diela) në të cilën Banka dhe bankat tregtare janë të hapura për aktivitetet të zakonshëm në Luksemburg.

“Ngjarja e Ndryshimit të Ligjit” ka kuptimin e dhënë asaj në nenin 4.03A(3).

“Kontratë” ka kuptimin e dhënë asaj në hyrjen (6).

“Kredi” ka kuptimin e dhënë asaj në nenin 1.01.

“Zhdëmtim për Shtyrjet e Afatit” është një zhdëmtim i llogaritur mbi shumën e disbursimit të shtyrë ose pezulluar me një normë përqindjeje (nëse është më e lartë se zero) nëpërmjet të cilit:

-norma e interesit që do të ishte i zbatueshme për këtë shumë nëse do të ishte disbursuar tek Huamarrësi në Datën e Caktuar të Disbursimit;

tejkalon:

-Normën Përkatëse Ndërbankare (një normë mujore) minus 0,125% (12.5 pikë bazë), përveç kur kjo vlerë është më e vogël se zero, ku në një rast të tillë do të shënohet zero.

Një zhdëmtim i tillë llogaritet nga Data e Caktuar e Disbursimit deri në Datën e Disbursimit ose, sipas rastit, deri në datën e anulimit të Transhit të Njoftuar në pajtim me këtë Kontratë.

“Datë Disbursimi” është data në të cilën bëhet nga Banka disbursimi faktik i një Transhi.

“Njoftim i Disbursimit” është një njoftim nga Banka drejtuar Huamarrësit në pajtim me dhe sipas nenit 1.02C.

“Kërkesë Disbursimi” është një njoftim në formë kryesisht i përcaktuar në skedulën C.1.

“Ngjarje Ndërprerëse” është një ose të dyja së bashku:

a) një ndërprerje e konsiderueshme në ato sisteme pagese ose komunikimi ose në ato tregje financiare të cilat, në çdo rast, kërkohet të jenë operacionale në mënyrë që të bëhen pagesat në lidhje me këtë Kontratë; ose

b) ndodhia e një ngjarjeje tjetër e cila rezulton në një ndërprerje (të një natyre teknike ose në lidhje me sistemet) për operacionet e thesarit ose pagesave të Bankës ose Huamarrësit, që e pengojnë atë palë:

(i) nga përmbushja e detyrimeve të saj për pagesa sipas kësaj Kontrate; ose

(ii) nga komunikimi me palët e tjera,

dhe kjo ndërprerje (në çdo rast të tillë si në ato (a) ose (b) më sipër) nuk shkaktohet dhe është tej kontrollit të palës operacionet e së cilës ndërpritën.

“Deklarimi i BEI-t për Parimet dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale” është deklarata e publikuar në faqen e internetit të BEI-t¹ që përcakton standardet që Banka kërkon për projektet që ajo financon dhe përgjegjësitë e palëve të ndryshme.

“Mjedis” ka kuptimin sa më poshtë, në masën që ato prekin shëndetin e njeriut dhe mirëqenien sociale:

a) fauna dhe flora;

b) toka, uji, ajri, klima dhe peizazhi; dhe

c) trashëgimia kulturore dhe mjedisi i ndërtuar, dhe përfshin, pa kufizim, shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës dhe komunitet.

“Aprovim Mjedisor” është çdo autorizim i kërkuar nga ligji i mjedisit.

“Dokumente Mjedisore dhe Sociale” është: a) Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social; b) Përmbledhje Joteknike dhe Plani i Veprimtimit Rivendosës.

“Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social” është plani i Zbatuesit i datës 20 qershor 2013 paraqitur Bankës në lidhje me Projektin i cili përcakton masat fuqizuese zbutëse/përforsuese, monitoruese, konsultative dhe institucionale të parashikuara për të parandaluar, minimizuar, zbutur ose kompensuar ndikimin negativ mjedisor dhe social dhe për të fuqizuar ndikimin përfitues të Projektit duke specifikuar si, kur dhe nga kush do të zbatohen këto masa, që ndryshohen here pas here në pajtim me miratimin e Bankës.

“Standardet Mjedisore dhe Sociale” janë:

a) Ligjet mjedisore dhe ligjet sociale që zbatohen për Projektin ose Huamarrësin;

¹ Në datën e Kontratës është e disponueshme në këtë lidhje: http://www.eib.org/attachments/strategies/eib_statement_esps_en.pdf



b) Deklarimi i BEI-t për Parimet dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale;

c) Dokumentet mjedisore dhe sociale.

“Aprovimi Mjedisor ose Social” është çdo leje, licencë, autorizim, pëlqim ose aprovim tjetër i kërkuar nga ligji mjedisor ose ligji social në lidhje me ndërtimin ose operimin e Projektit.

“Pretendim Mjedisor ose Social” është çdo pretendim, procedim, njoftim formal ose hetim nga çdo person në lidhje me Çështjet Mjedisore ose Sociale që cenojnë Projektin duke përfshirë çdo shkelje ose shkelje të pretenduar të një ligji mjedisor dhe standardi social.

“Ligj mjedisor” është:

a) ligj i BE-së, duke përfshirë parimet dhe standardet;

b) ligjet dhe rregulloret kombëtare të Republikës së Shqipërisë; dhe

c) traktatet e zbatueshme ndërkombëtare për të cilat objektivi kryesor është ruajtja, mbrojtja ose përmirësimi i mjedisit.

“EURIBOR” ka kuptimin e dhënë asaj në skedulit B.

“EUR” ose “euro” është monedha e ligjshme e shteteve anëtare të Bashkimit European që e miratojnë ose kanë miratuar atë si monedhën e tyre në pajtim me dispozitat përkatëse të Traktatit të Bashkimit European dhe Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit European ose traktatet pasuese të tyre.

“Rast i Mosplotësimit të Detyrimeve” është çdonjë prej rrethanave, ngjarjeve ose ndodhive të specifikuar në nenin 10.01.

“Instrument i Borxhit të Jashtëm” ka kuptimin e dhënë atij në nenin 7.01.

“Datë e Fundit e Disponueshmërisë” është (DATA)²

“Financimi i Terrorizmit” është sigurimi ose mbledhja e fondeve, nëpërmjet çdo mënyre, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, me synim që ato të përdoren ose në dijeninë që ato do të përdoren, plotësisht ose pjesërisht, për të kryer vepra penale brenda kuptimit të neneve 1 deri 4 të Vendimit Kuadër të Këshillit të BE-së 2002/475/JHA të datës 13 qershor 2002 mbi luftën kundër terrorizmit.

“Normë Fikse” është një normë vjetore interesi e përcaktuar nga Banka në pajtim me parimet e zbatueshme herë pas here të përcaktuara nga organet qeverisëse të Bankës për huat e dhëna me një normë

fikse interesi, e përcaktuar në monedhën e Transhit dhe që ka terma të barasvlershëm për shlyerjen e kapitalit dhe pagesën e interesit.

“Transhi me Normë Fikse” është një Transh për të cilin aplikohet një Normë Fikse.

“Normë e Ndryshueshme” do të thotë një normë interesi e ndryshueshme me shpërndarje fikse, që do të thotë një normë interesi vjetore e përcaktuar nga Banka për çdo Periudhë pasuese Reference me Normë të Ndryshueshme të barabartë me Normën Përkatëse Ndërbankare plus *spread*-in.

“Periudhë Reference me Normë të Ndryshueshme” do të thotë çdo periudhë nga një Datë Pajese në Datën tjetër përkatëse të Pagesës; Periudha e parë e Referencës me Normë të Ndryshueshme fillon në datën e disbursimit të Transhit.

“Transhi me Normë të Ndryshueshme” është një Transh për të cilin aplikohet një Normë e Ndryshueshme.

“Formulari A/B” është çdo formular në formë thelbësisht si të dokumentacionit bashkëlidhur skedulit E.

“GAAP” janë parimet e kontabilitetit përgjithësisht të zbatuara në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë IFRS-në.

“Udhëzim Prokurimi” është Udhëzimi për Prokurimin i publikuar në faqen e BEI-t³ që informon zbatuesit e projekteve të financuar tërësisht ose pjesërisht nga BEI për masat që duhen marrë për prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për Projektin.

“IFRS” janë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit brenda kuptimit të Rregullores IAS 1606/2002 në masën e zbatueshme për deklarimet financiare përkatëse.

“ILO” është Organizata Ndërkombëtare e Punës.

“Standarde të ILO-s” është çdo traktat, konventë ose detyrim i ILO-s i nënshkruar dhe ratifikuar apo ndryshe i zbatueshëm dhe detyrues për Huamarrësin, dhe Standardet Thelbësore të Punës (siç përkufizohen në Deklaratën e ILO-s mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë).

“Ngjarje e Parapagimit të Kompensimit” është një Ngjarje e Parapagesës e ndryshme nga ato të parashikuara në paragrafët 4.03A(2) ose 4.03A(4).

² Data që bie dyzet e tetë muaj pas datës së kësaj kontrate.

³<http://www.eib.org/projects/publications/guide-to-procurement.htm>. Vini re që është versioni i Udhëzimit në fuqi në momentin e prokurimit të projektit që është i zbatueshëm.



“Hua” është shuma e plotë e Transheve të disbursuara herë pas here nga Banka sipas kësaj Kontrate.

“Ngjarje Ndërprerëse e Tregut” është një prej rrethanave të mëposhtme:

a) sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, ka ngjarje ose rrethana që ndikojnë negativisht në aksesin e Bankës në burimet e saj të financimit;

b) sipas mendimit të Bankës, fondet nuk ofrohen nga burimet e saj të zakonshme të financimit me qëllim financimin në mënyrë të përshtatshme të një Transhi në monedhën përkatëse dhe/ose për maturimin përkatës dhe/ose në lidhje me profilin e rimbursimit të këtij Transhi;

c) në lidhje me një Transh për të cilin është ose do të ishte i pagueshëm interesi me një Normë të Ndryshueshme:

A. kostoja e Bankës për marrjen e fondeve nga burimet e saj të financimit, siç përcaktohet nga Banka, për një periudhë të barabartë me periudhën e Referencës së Normës të Ndryshueshme të këtij Transhi (d.m.th., në tregun e parasë) do të ishte mbi Normën e Zbatueshme Përkatëse Ndërbankare;

ose

B. Banka përcakton që nuk ekzistojnë mjete të përshtatshme dhe të ndershme për të konstatuar Normën e zbatueshme Përkatëse Ndërbankare për monedhën përkatëse të këtij Transhi ose nuk është e mundur të përcaktohet Norma Përkatëse Ndërbankare në pajtim me përkufizimin që gjendet në skedulin B.

“Ndryshim Material i Pafavorshëm” është, në lidhje me Huamarrësin, çdo ngjarje ose ndryshim i gjendjes që ndikon Huamarrësin, i cili, sipas mendimit të Bankës:

a) cenon në masë të konsiderueshme aftësinë Huamarrësit për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Kontrate; ose

b) cenon në masë të konsiderueshme pronën, gjendjen financiare ose perspektivën e Huamarrësit.

“Datë Maturimi” është data e fundit ose e vetme e shlyerjes së një Transhi e specifikuar në pajtim me nenin 4.01A(b)(iv) ose nenin 4.01B.

“Pastrim i parave” është:

i) konvertimi ose transferimi i pronës, duke ditur që kjo pronë ka rrjedhur nga aktiviteti kriminal ose nga një veprim pjesëmarrës në këtë aktivitet, me synim fshehjen ose maskimin e origjinës së paligjshme të pronës ose asistimin e një personi i cili është i përfshirë në kryerjen e këtij aktiviteti për t’iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tij;

ii) fshehja ose maskimi i natyrës, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes, të drejtave të lidhura ose pronësisë së vërtetë të pronës, duke ditur që kjo pronë ka rrjedhur nga aktiviteti kriminal ose nga një pjesëmarrje në një aktivitet të tillë;

iii) përfutimi, zotërimi ose përdorimi i pronës, duke ditur në kohën e marrjes se kjo pronë ka rrjedhur nga aktiviteti kriminal ose nga një veprim i pjesëmarrjes në një aktivitet të tillë; ose

iv) pjesëmarrja, bashkimi për të kryer, përpjekjet për të kryer dhe ndihmuar, nxitur, lehtësuar dhe këshilluar kryerjen e një prej veprimeve të përmendura në pikat e mësipërme.

“Transh i Njoftuar” është një Transh në lidhje me të cilin Banka ka nxjerrë një Njoftim Disbursimi.

“Data e Pagesës” do të thotë datat vjetore, gjashtë-mujore ose tremujore të specifikuara në Njoftimin e Disbursimit deri në Datën e Maturimit, përveç kur, në rast kur një datë e tillë nuk është një Ditë Pune Përkatëse, do të thotë:

a) për një Transh me Normë Fikse, Dita Përkatëse pasuese e Punës, pa e përshtatur interesin e kërkuar sipas nenit 3.01, përveç atyre rasteve kur shlyerja kryhet në një kësht të vetëm sipas nenit 4.01B, kur Dita Përkatëse pararendëse e Punës do të zbatohet në vend të këtij kështi të vetëm dhe për pagesën përfundimtare të interesit dhe vetëm në këtë rast, me përshtatje të interesit të kërkueshëm sipas nenit 3.01; dhe

b) për një Transh me Normë të Ndryshueshme, dita pasuese, sipas rastit, e atij muaji kalendarik që është një Ditë Përkatëse Pune ose, në mungesë të saj, dita me e afërt pararendëse që është një Ditë Përkatëse Pune, në të gjithë rastet me përshtatjen përkatëse për interesin e kërkueshëm sipas nenit 3.01.

“PEP” është një Person i Ekspozuar Politikisht siç përkufizohet nga direktiva e Komisionit 2006/70/EC të datës 1 gusht 2006, i ndryshuar, i konsoliduar ose i ndryshuar herë pas here.

“Shuma e Parapagimit” është shuma e një Transhi që parapaguhet nga Huamarrësi në pajtim me nenin 4.02A.

“Data e Parapagimit” është data, e cila do të jetë një Datë Pageje, në të cilën Huamarrësi propozon të kryejë parapagimin e një Shume Parapagimi.

“Ngjarje Parapagimi” është një prej ngjarjeve të përshkruara në nenin 4.03A.

“Zhdëmtim Parapagimi” është në lidhje me çdo shumë principale që parapaguhet ose anulohet, shuma e komunikuar nga Banka Huamarrësit si vlerë e tashme (e Datës së Parapagimit) të shtesës, sipas rastit, të:



a) interesit që mblidhet pas këtij momenti mbi Shumën e Parapagesës gjatë periudhës nga Data e Parapagimit deri në Datën e Maturimit, nëse nuk do të ishte parapaguar; mbi

b) interesin që do të mblidhej gjatë asaj periudhe, nëse do të llogaritej në Datën e Riaktivizimit, minus 0,15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë).

Kjo vlerë aktuale do të llogaritet me një normë zbritjeje të barabartë me Normën e Riaktivizimit, të zbatuar në çdo Datë përkatëse të Pagesës.

“Njoftim i Parapagimit” është një njoftim me shkrim nga Banka drejtuar Huamarrësit në pajtim me dhe sipas nenit 4.02A.

“Kërkesë Parapagimi” është një kërkesë me shkrim nga Huamarrësi drejtuar Bankës për të parapaguar të gjithë ose një pjesë të Huas në pajtim me nenin 4.02A.

“Sjellje e Ndaluar” është çdo Financim i Terrorizmit, Pastrim Parash ose Praktikë e Ndaluar.

“Praktikë e Ndaluar” është çdo:

i) “Praktikë Detyruese” që është cenimi ose dëmtimi, ose rrezikimi për të cenuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, një palë ose pasurinë e një pale për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një pale.

ii) “Praktikë e Fshehtë” që është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve e përcaktuar për të arritur një qëllim të parregullt, duke përfshirë ndikimin në mënyrë të parregullt të veprimeve të një pale tjetër;

iii) “Praktikë Korruptive” që është ofrimi, dhënia, marrja ose kërkimi, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, i çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një pale tjetër;

iv) “Praktikë Mashtrimi” që është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, e cila çorienton ose përpiket të çorientojë me dashje ose nga pakujdesia një palë për të përfutur një përfitim financiar ose përfitim tjetër ose të mënjanojë një detyrim; ose

v) “Praktikë Penguese” që do të thotë në lidhje me një hetim në një Praktikë Detyruese, të Fshehtë, të Korruptuar ose Mashtruese në lidhje me këtë Hua ose Projekt: a) prish, falsifikon, ndryshon ose fsheh në mënyrë të qëllimshme prova të konsiderueshme për hetimin; dhe/ose kërcënon, ngacmon ose tremb një palë për ta penguar atë në deklarimin e njohurive të saj për çështjet në lidhje me hetimin ose ndjekjen e hetimit; ose b) veprime që synojnë të pengojnë në mënyrë të konsiderueshme ushtrimin e të drejtave

kontraktuale të auditimit ose aksesit të informacionit.

“Projekt” ka kuptimin e dhënë atij në paragrafin hyrës (1).

“Ekip i Zbatimit të Projektit” ka kuptimin e dhënë atij në nenin 1.04.

“Shpenzim Kualifikues” është shpenzimi total (duke përfshirë kostot e projektimit dhe mbikëqyrjes, sipas rastit, dhe duke zbritur taksat dhe detyrimet të pagueshme nga Huamarrësi) i kryer nga Huamarrësi për Projektin, në lidhje me punët e specifikuar në Përshkrimin Teknik si të përshtatshëm për financimin sipas Kredisë, që kanë qenë objekt i kontratës ose kontratave të nënshkruara sipas termave të pranueshëm për Bankën, duke pasur parasysh botimin e fundit të Udhëzimit të Bankës për Prokurimin, që publikohet në faqen e saj të internetit. Për qëllime të llogaritjes së ekuivalentit në euro të çdo shume të shpenzuar në një monedhë tjetër, Banka do të zbatojë normën e këmbimit të referencës të llogaritur dhe publikuar për atë monedhë nga Banka Europiane Qendrore për atë datë që bie pesëmbëdhjetë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së disbursimit që do të vendosë Banka (ose, nëse nuk ka një normë të tillë, norma ose normat përkatëse të këmbimit që mbizotërojnë në një treg financiar të zgjedhur në mënyrë të arsyeshme nga Banka).

“Norma e Riaktivizimit” do të thotë Norma Fikse në fuqi në ditën e llogaritjes së zhdëmtimit për huatë me normë fikse të përcaktuara në të njëjtën monedhë dhe që do të ketë të njëjtat terma për pagesën e interesit dhe të njëjtin profil shlyerjeje në Datën e Maturimit si dhe Transhi për të cilin propozohet ose kërkohet të bëhet parapagesa. Për ato raste kur periudha është më e shkurtër se 48 (dyzet e tetë) muaj (ose 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj në mungesë të një shlyerjeje të principalit gjatë asaj periudhe) do të përdoret ekuivalenti i normës së tregut të parasë që përputhet më shumë, që është Norma Përkatëse Ndërbankare minus 1.25% (12.5 pikë bazë) për periudhat deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj. Për periudhat që janë ndërmjet 12 (dymbëdhjetë) dhe 36 (tridhjetë e gjashtë)/48 (dyzet e tetë) muaj sipas rastit, zbatohet pika e ofruar mbi normat e këmbimit sipas publikimit të Reuters për monedhën përkatëse dhe që respektohet nga Banka në momentin e llogaritjes.

“Ditë Përkatëse Pune” do të thotë:

a) për euron, një ditë në të cilën është i hapur për kryerjen e pagesave në euro sistemi i pagesave Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer që përdor një platformë të vetme të



përbashkët dhe që ka filluar më 19 nëntor 2007 (TARGET 2)⁴; dhe

b) për çdo monedhë tjetër, një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë të zakonshme në qendrën financiare kryesore të brendshme të monedhës përkatëse.

“Norma Përkatëse Ndërbankare” është EURIBOR-i.

“Plani i Veprimit Rivendosës” është plani i datës 20 qershor 2013 i finalizuar nga Zbatuesi dhe rënë dakord me Bankën dhe i miratuar nga autoritetet kompetente në kontekstin e Miratimeve Mjedisore ose Sociale, duke parashikuar me hollësi veprimet që duhet të ndërmerren për të rivendosur dhe kompensuar njerëzit që janë ose do të zhvendosen fizikisht ose ekonomikisht si rezultat i zbatimit të Projektit, i cili mund të ndryshohet herë pas here, në pajtim me pëlqimin e Bankës.

“Direktiva e Menaxhimit të Sigurisë së Infrastrukturës Rrugore” është direktiva 2008/96/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, që ndryshohet dhe plotësohet herë pas here.

“Personat e Sanksionuar” është çdo individ ose subjekt i përfshirë në një ose me shumë Lista Sanksionesh.

“Listat e Sanksioneve” janë:

i) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare dhe embargot e armëve të nxjerra nga Bashkimi Europian në pajtim me kapitullin 2 të titullit V të Traktatit mbi Bashkimin Europian, si dhe nenin 215 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian që gjendet në faqet e internetit të BE-së http://eeas.europa.eu/cfsp/sanctions/consolidated_en.htm dhe http://eeas.europa.eu/cfsp/sanctions/docs/measures_en.pdf, të ndryshuar dhe plotësuar herë pas here ose në çdo faqe pasuese; ose,

ii) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare dhe embargot e armëve të nxjerra nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në pajtim me nenin 41 të Kartës së OKB-së që gjendet në faqen zyrtare të OKB-së

“Listat e Sanksioneve” janë:

⁴ Më 14 dhjetor 2000, Këshilli Qeverisës i Bankës Qendrore Europiane (ECB) ka vendosur që nga viti 2002 deri në një njoftim tjetër, sistemi Trans-European Automated Real-time Gross Settlement Express Transfer 2 (TARGET 2), përveç të shtunave dhe të dielave, në ditën e mëposhtme, do të jetë i mbyllur në Ditën e Vitit të Ri, të Premten e Zezë dhe të hënën e pashkëve, 1 maj, Ditën e Krishtlindjeve dhe 26 dhjetor.

http://www.un.org/sc/committees/list_compend.shtml, të ndryshuar dhe plotësuar herë pas here ose në çdo faqe pasuese.

“Ligj social” është secili prej:

a) ligjeve, rregullave ose rregulloreve të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë në lidhje me çështjet sociale;

b) Standardeve të ILO-s;

c) traktateve, konventave ose detyrimeve të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut të nënshkuara dhe ratifikuara ose ndryshe të zbatueshme dhe detyruese për Republikën e Shqipërisë.

“Çështje Sociale” janë të gjitha, ose secila prej, sa më poshtë: i) kushtet e punës dhe punësimit; ii) shëndeti dhe siguria në vendin e punës; iii) mbrojtja dhe fuqizimi i të drejtave dhe interesave të popullsisë vendase, minoritetëve etnike dhe grupeve të prekshme; iv) trashëgimia kulturore (e prekshme dhe jo e prekshme); v) shëndeti, garantimi dhe siguria publike; vi) rivendosja fizike e pavullnetshme dhe/ose zhvendosja ekonomike dhe humbja e mjeteve të jetesës së personave; dhe vii) pjesëmarrja publike dhe angazhimi i grupeve të interesit.

“Data e Disbursimit të Planifikuar” është data në të cilën një Transh është planifikuar të disbursohet në pajtim me nenin 1.02C.

“Garanci” është hipoteka, pengu, barra, kalimi, transferimi, hipotekimi ose një mjet tjetër sigurimi të padisë që siguron një detyrim të një personi ose një marrëveshje tjetër ose masë që ka efekt të ngjashëm.

“Spread” do të thotë diferenca fikse me Normën Përkatëse Ndërbankare (duke qenë plus ose minus) e përcaktuar nga Banka dhe që i njoftohet Huamarrësit në Njoftimin përkatës të Disbursimit.

“Taksë” është çdo taksë, detyrim, tarifë, pagesë ose tatim ose mbajtje me natyrë të ngjashme (duke përfshirë çdo gjë ose interes të pagueshëm në lidhje me çdo dështim për të paguar ose vonesë në këtë pagesë).

“Përshkrim Teknik” ka kuptimin e dhënë atij në paragrafin hyrës (1).

“Transh” është çdo disbursim i bërë ose që duhet të bëhet sipas kësaj Kontrate. Në rast se nuk është bërë Njoftim Disbursimi, Transhi do të thotë një Transh siç parashikohet sipas nenit 1.02B.

Neni 1

Kredia dhe disbursimet

1.01 Shuma e Kredisë

Nëpërmjet kësaj Kontrate Banka jep në favor të Huamarrësit, dhe Huamarrësi pranon, një kredi në



shumën 18,000,000.00 euro (tetëmbëdhjetë milionë euro) për financimin e Projektit (“Kredia”).

1.02 Procedura e disbursimit

1.02A Transhet

Banka do ta disbursojë Kredinë në deri 6 (gjashtë) transhe. Shuma e çdo transhi, nëse nuk është balanca e patërhequr e Kredisë, do të ketë një shumë minimale prej 3,000,000.00 euro (tre milionë euro).

1.02B Kërkesa për disbursim

a) Huamarrësi, mund, drejtpërdrejt, ose nëpërmjet Zbatuesit (i autorizuar rregullisht nga Huamarrësi), t'i paraqesë Bankës një Kërkesë për Disbursim për disbursimin e një Transhi, ku një Kërkesë e tillë Disbursimi duhet të merret të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para Datës së Fundit të Disponueshmërisë. Kërkesa për Disbursim do të ketë formën e parashikuar në skedulën C.1 dhe do të specifikojë:

- i) shumën dhe monedhën e Transhit;
- ii) datën e preferueshme të disbursimit të Transhit; ku kjo datë e preferuar e disbursimit duhet të jetë një Ditë Përkatëse Pune që bie të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas datës së Kërkesës për Disbursimit dhe, në çdo rast, në ose para Datës së Fundit të Disponueshmërisë, ku kuptohet që pavarësisht Datës së Fundit të Disponueshmërisë Banka mund ta disbursojë Transhin deri në 4 (katër) muaj kalendarikë nga data e Kërkesës për Disbursim;
- iii) nëse Transhi është një Transh me Normë Fikse apo një Transh me Normë të Ndryshueshme, të gjitha në pajtim me dispozitat përkatëse të nenit 3.01;
- iv) periodicitetin e preferuar të pagesës së interesit për Transhin, të zgjedhur në pajtim me nenin 3.01;
- v) termat e preferuar të shlyerjes së principalit për Transhin, të zgjedhur në pajtim me nenin 4.01;
- vi) datën e parë dhe të fundit të preferuar për shlyerjen e principalit për Transhin; dhe
- vii) kodin IBAN (ose formatin e përshtatshëm në pajtim me praktikën lokale bankare) dhe SWIFT BIC të llogarisë bankare ku duhet të bëhet disbursimi i Transhit në pajtim me nenin 1.02D.

b) Nëse Banka, pas një kërkesë të bërë nga Huamarrësi, i ka dhënë Huamarrësit, para paraqitjes së Kërkesës për Disbursim, një normë interesi fikse jo-detyruese ose një kuotim *spread*-i të zbatueshëm për Transhin, Huamarrësi, në diskrecionin e tij, mund gjithashtu të specifikojë në Kërkesën për Disbursim këtë kuotim, që do të thotë:

i) në rastin e një Transhi me Normë Fikse, normën e sipërpërmendur të interesit fikse që është kuotuar më parë nga Banka; ose

ii) në rastin e një Transhi me Normë të Ndryshueshme, *spread*-in e sipërpërmendur që është kuotuar më parë nga Banka,

të zbatueshme për Transhin deri në Datën e Maturimit.

c) Çdo Kërkesë për Disbursim do të shoqërohet me provat e autoritetit të personit ose personave të autorizuar për ta nënshkruar atë dhe specimenet e nënshkrimeve të këtij personi ose personave; për mënjanimin e dyshimit, Kërkesat për Disbursim pas së parës të nënshkruar nga i njëjti nënshkrues ose të njëjtit nënshkrues si e para, këto prova mund të përfshijnë një kopje të të njëjtës provë shkresore për autoritetin e dhënë për Kërkesën e parë për Disbursim më kusht që të mos jetë subjekt i limiteve apo kufizimeve kohore apo të tjera.

d) Në pajtim me nenin 1.02(b), çdo Kërkesë për Disbursim është e përvokueshme.

1.02C Njoftim disbursimi

a) Jo më pak se 10 (dhjetë) ditë para Datës së propozuar të Disbursimit të Planifikuar të një Transhi, nëse Kërkesa e Disbursimit është në pajtim me këtë nen 1.02, Banka do t'i bëjë Huamarrësit një Njoftim Disbursimi, i cili specifikon:

- (i) shumën dhe monedhën e Transhit;
- (ii) Datën e Disbursimit të Planifikuar;
- (iii) bazën e normës së interesit për Transhin, që është: i) një Transh me Normë Fikse; ose ii) një Transh me Normë të Ndryshueshme të gjitha në pajtim me dispozitat përkatëse të nenit 3.01;
- (iv) Datën e parë të Pagesës së interesit dhe periodicitetin për pagesën e interesit për Transhin;
- (v) termat për shlyerjen e principalit për Transhin;
- (vi) datat e para dhe të fundit për shlyerjen e principalit për Transhin;
- (vii) Datat e zbatueshme të Pagesës për Transhin; dhe

(viii) për një Transh me Normë Fikse Norma Fikse dhe për një Transh me Normë të Ndryshueshme *Spread*-i i zbatueshëm për Transhin deri në Datën e Maturimit.

b) Nëse një ose më shumë elementa të speci-fikuara në Njoftimin e Disbursimit nuk reflekton elementin përkatës, sipas rastit, në Kërkesën e Disbursimit, Huamarrësi, pas marrjes së Njoftimit të Disbursimit mund ta tërheqë Kërkesën për Disbursim me njoftim me shkrim drejtuar Bankës që duhet të merret jo më



vonë se ora 12 00 sipas orës së Luksemburgut në Ditën pasuese të Punës dhe pas kësaj kërkesa e Disbursimit dhe Njoftimi i Disbursimit nuk do të kenë fuqi. Nëse Huamarrësi nuk e ka tërhequr me shkrim Kërkesën për Disbursim brenda kësaj periudhe, Huamarrësi do të konsiderohet t'i ketë pranuar të gjithë elementët e specifikuar në Njoftimin e Disbursimit.

c) Nëse Huamarrësi i ka paraqitur Bankës një Kërkesë Disbursimi në të cilën Huamarrësi nuk ka specifikuar normën e interesit fiks ose *spread*-in e parashikuar në nenin 1.02B(b), Huamarrësi do të konsiderohet të ketë rënë dakord paraprakisht me Normën Fikse ose *Spread*-in që specifikohet më vonë në Njoftimin e Disbursimit.

1.02DLlogaria e disbursimit

Disbursimi do të bëhet në atë llogari të Huamarrësit që Huamarrësi do t'i njoftojë me shkrim Bankës jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para Datës së Disbursimit të Planifikuar (me kodin IBAN ose me formatin e përshtatshëm në pajtim me praktikën bankare lokale) në Kërkesën e Disbursimit.

Për çdo Transh mund të specifikohet vetëm një llogari.

1.03 Monedha e disbursimit

Banka do ta disbursojë çdo Transh në euro.

1.04 Kushtet e disbursimit

1.04A Transhi i parë

Disbursimi i Transhit të parë sipas nenit 1.02 kushtëzohet me marrjen nga Banka, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, më ose para marrjes së Kërkesës së Disbursimit, të dokumenteve ose provave të mëposhtme:

a) prova që nënshkrimi i kësaj Kontrate nga Huamarrësi është autorizuar rregullisht dhe që personi që e nënshkruan Kontratën në emër të Huamarrësit është autorizuar të bëjë këtë;

b) provë në lidhje me delegimin e autoritetit për të nënshkruar kërkesat për disbursim. Nëpërmjet kësaj, Ministri është i autorizuar t'ia delegojë këtë autoritet personave të autorizuar nga ai herë pas here;

c) një mendim ligjor të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë së Huamarrësit që konfirmon:

(i) që nënshkrimi i kësaj Kontrate nga Huamarrësi është autorizuar rregullisht dhe që personi që e nënshkruan Kontratën në emër të Huamarrësit është i autorizuar të bëjë këtë;

(ii) që lidhja e kësaj kontrate dhe nënshkrimi nga Huamarrësi janë ratifikuar rregullisht me ligj në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë;

(iii) kjo Kontratë është tërësisht në fuqi dhe e

vlefshme, detyruese dhe e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë në përputhje me kushtet e saj;

(iv) që Zbatuesi do t'i ketë marrë të gjitha pëlqimet, autorizimet, licencat ose aprovimet e nevojshme nga organet qeveritare ose publike ose autoritetet e kërkuara në lidhje me këtë Kontratë brenda datës së Disbursimit të Planifikuar;

(v) që asnjë kufizim kontrolli, këmbimi apo leje nuk kërkohet, në mënyrë që të lejohet marrja e të gjitha shumave që do të disbursohen në llogarinë e veçantë të përmendur në nenin 1.02D dhe për të lejuar shlyerjen e Huas dhe pagimin e interesit dhe të gjitha shumave të tjera sipas kësaj Kontrate;

d) prova që Zbatuesi i ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme (qoftë nga autoritetet publike dhe qeveritare apo tjetër), që kërkohen në lidhje me zbatimin e Projektit;

e) prova që autoriteti kompetent mjedisor ka nxjerrë vendimin e tij pozitiv për projektin dhe që janë marrë të gjitha Aprovimet e nevojshme Mjedisore (për t'u siguruar nga Zbatuesi);

f) prova që autoriteti kompetent për konservimin e natyrës ka lëshuar mendimin e tij për rëndësinë e ndikimit të projektit në zonat dhe speciet e mbrojtura në formën e Formularit A/B ose të barasvlershme (për t'u siguruar nga Zbatuesi);

g) prova që autoriteti kompetent për arkeologjinë, kulturën dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore ka dhënë mendimin e tij mbi rëndësinë e ndikimit të Projektit mbi vendndodhjet e mbrojtura (për t'u siguruar nga Zbatuesi);

h) prova që është aprovuar një Plan Veprimi Rivendosjeje, i pranueshëm për Bankën, nga autoritetet përkatëse (për t'u siguruar nga Zbatuesi); dhe

i) prova nga Zbatuesi që ka përfunduar plotësisht gjithë përfundimi i tokës i nevojshëm për zbatimin e Projektit dhe Planin e Veprimit të Rivendosjes në lidhje me Projektin është plotësisht i përfunduar.

1.04B Të gjitha transhet

a) Disbursimi i të gjithë Transheve sipas nenit 1.02, duke përfshirë të parën, kushtëzohet me marrjen nga Banka, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, më ose para marrjes së Kërkesës së Disbursimit, të dokumenteve ose provave të mëposhtme:

(i) një certifikatë nga Huamarrësi në formën e skedulit D mbi dokumentin me kokën e Huamarrësit dhe me datë jo më parë se data që është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para Datës së Disbursimit të Planifikuar;



(ii) prova nga Zbatuesi për respektimin e kërkesave të sigurimit në pajtim me nenin 6.05(c);

(iii) provë nga Zbatuesi që ekipi përgjegjës për zbatimin e Projektit dhe për të koordinuar, menaxhuar, monitoruar të gjitha aspektet e zbatimit, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve për Projektin (i referuar gjithashtu si departamenti i menaxhimit të projekteve në ARA) (“Ekipi i Zbatimit të Projektit”) është funksional i cili është me personel të përshtatshëm dhe të kualifikuar, ka burime të mjaftueshme, kompetencë dhe asistencë teknike dhe terma të përshtatshëm reference, secila e pranueshme për Bankën, dhe është përgjegjëse, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit për bashkërendimin e Projektit;

(iv) prova nga Zbatuesi që një inxhinier i pavarur mbikëqyrës me personel, burime dhe terma reference të pranueshme për Bankën është i mobilizuar plotësisht;

(v) prova nga Zbatuesi që demonstrojnë se, pas tërheqjes së Transhit përkatës, shuma e plotë e Huas nuk do të tejkalojë shpenzimin e plotë të shkaktuar ose të marrë përsipër në kontratë nga Huamarrësi në lidhje me Projektin deri në datën e Kërkesës përkatëse të Disbursimit; dhe

(vi) një kopje e çdo autorizimi ose dokumenti, mendimi apo garancie tjetër që Banka, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, ka njoftuar Huamarrësin që është e nevojshme në lidhje me Kontratën;

(vii) përveç se për Transhin e parë, prova që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që Huamarrësi dhe/ose Zbatuesi do të ketë realizuar, brenda ditës së 120-të që bie pas datës së preferuar të Disbursimit të specifikuar në Kërkesën e Disbursimit, Shpenzimin Kualifikues në një shumë të paktën të barabartë me shumën e: i) 100% të shumave të Transheve të disbursuar më parë; dhe ii) 80% të shumave të Transhit që duhet të disbursohen (100% të shumës së Transhit, nëse ky Transh është Transhi i fundit për t’u disbursuar);

b) që në Datën e Disbursimit për Transhin e propozuar:

i) përfaqësimet dhe garancitë që janë përsëritur në pajtim me nenin 6.09 janë të sakta në të gjitha aspektet; dhe

ii) asnjë ngjarje ose rrethanë që përbën ose do të përbente me kalimin e kohës ose bërjen e njoftimit sipas kësaj Kontrate:

aa) një Rast të Mosplotësisht të Detyrimeve; ose

bb) një Ngjarje Parapagimi,

nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon e pakorrigjuar ose pa hequr dorë ose që do të rezultonte nga Disbursimi i Transhit të propozuar.

1.05 Shtyrja e Disbursimit

1.05A Shkaqet e shtyrjes

Me kërkesën me shkrim të Huamarrësit, Banka do ta shtyjë disbursimin e çdo Transhi të Njoftuar plotësisht ose pjesërisht në një datë të specifikuar nga Huamarrësi që është datë që bie jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga Data e Disbursimit të Planifikuar dhe jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë para datës së parë të pagesës së Transhit të treguar në Njoftimin e Disbursimit. Në një rast të tillë, Huamarrësi do të paguajë Zhdëmtimin e Shtyrjes së Afatit të llogaritur mbi shumën e disbursimit të shtyrë.

Çdo kërkesë për shtyrje do të hyjë në fuqi në lidhje me një Transh vetëm nëse bëhet të paktën 5 (pesë) Ditë Pune para Datës së Disbursimit të Planifikuar.

Nëse për një Transh të Njoftuar nuk është përmbushur një prej kushteve të përmendura në nenin 1.04 në datën e specifikuar dhe në Datën e Disbursimit të Planifikuar (ose datën e pritshme për disbursim në rastin e një shtyrjeje të mëparshme), disbursimi do të shtyhet në një datë të rënë dakord ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit që bie jo më parë se 5 (pesë) Ditë Pune pas përmbushjes së të gjitha kushteve të disbursimit (pa cenuar të drejtën e Bankës të pezullojë dhe/ose anulojë pjesën e padisbursuar të Kredisë plotësisht ose pjesërisht në pajtim me nenin 1.06B). Në një rast të tillë, Huamarrësi do të paguajë Zhdëmtimin e Shtyrjes së Afatit të llogaritur mbi shumën e disbursimit të shtyrë.

1.05B Anulimi i një disbursimi të shtyrë me 6 (gjashtë) muaj

Banka, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të anulojë një disbursim i cili është shtyrë sipas nenit 1.05A me më shumë se 6 (gjashtë) muaj në tërësi. Shuma e anuluar do të mbetet e disponueshme për disbursim në pajtim me nenin 1.02.

1.06 Anulimi dhe pezullimi

1.06A E drejta e Huamarrësit për të anuluar

Huamarrësi në çdo kohë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Bankës, mund të anulojë plotësisht ose pjesërisht me efekt të menjëhershëm pjesën e padisbursuar të Kredisë. Megjithatë, njoftimi nuk do të ketë fuqi në lidhje me (i) një Transh të Njoftuar i cili ka një Datë Disbursimi të Planifikuar që bie brenda 5 (pesë) Ditëve Pune nga data e njoftimit ose (ii) një Transh në lidhje me të cilin një



Kërkesë Disbursimi është paraqitur por nuk është nxjerrë asnjë Njoftim Disbursimi.

1.06B E drejta e Bankës për të pezulluar dhe anuluar

a) Banka, nëpërmjet njoftimit me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të pezullojë dhe/ose anulojë pjesën e padisbursuar të Kredisë tërësisht ose pjesërisht në çdo kohë dhe me efekt të menjëhershëm pas ndodhës së Ngjarjes së Parapagesës ose një Rasti të Mosplotësimit të Detyrimeve ose të një ngjarjeje ose rrethane që me kalimin e kohës ose bërjen e njoftimit sipas kësaj Kontrate përbën Ngjarje të Parapagesës ose të një Rast të Mosplotësimit të Detyrimeve.

b) Banka mund të pezullojë gjithashtu pjesën e Kredisë në lidhje me të cilën ajo nuk ka lëshuar një Njoftim Disbursimi me efekt të menjëhershëm në rast se ndodh një Ngjarje e Ndërprerjes së Tregut.

c) Një pezullim do të vazhdojë derisa Banka të përfundojë pezullimin ose të anulojë shumën e pezulluar.

1.06C Zhdëmtimi për pezullimin dhe anulimin e një Transhi

1.06C (1) PEZULLIMI

Nëse Banka pezullon një Transh të Njoftuar, pas një Ngjarjeje të Zhdëmtimit të Parapagimit ose një Rasti të Mosplotësimit të Detyrimeve, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës Zhdëmtimin e Shtyrjes së Afatit të llogaritur për shumën e disbursimit të pezulluar.

1.06C (2) ANULIMI

Nëse në pajtim me nenin 1.06C Huamarrësi anulon:

a) një Transh me Normë Fikse që është një Transh i Njoftuar, ai do të zhdëmtojë menjëherë Bankën sipas nenit 4.02B;

b) Një Transh me Normë të Ndryshueshme që është një Transh i Njoftuar ose një pjesë të Kredisë të ndryshme nga një Transh i Njoftuar, nuk është i pagueshëm asnjë zhdëmtim.

Nëse Banka anulon:

(i) një Transh me Normë Fikse i cili është një Transh i Njoftuar pas një Ngjarjeje të Zhdëmtimit të Parapagimit ose në pajtim me nenin 1.05B, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës Zhdëmtimin e parapagimit; ose

(ii) një Transh të Njoftuar pas një Rasti të Mosplotësimit të Detyrimeve, Huamarrësi do të zhdëmtojë Bankën sipas nenit 10.03.

Përveç këtyre rasteve, asnjë zhdëmtim nuk është i pagueshëm me anulimin e një Transhi nga Banka.

Zhdëmtimi do të llogaritet sikur shuma e anuluar të jetë disbursuar dhe shlyer në Datën e Planifikuar të Disbursimit ose, në masën që disbursimi i Transhit tashmë shtyhet ose pezullohet, në datën e njoftimit të anulimit.

1.07 Anulimi pas skadimit të Kredisë

Në ditën pas Datës së Fundit të Disponibilitetit, dhe nëse nuk është rënë shprehimisht ndryshe me shkrim nga Banka, pjesa e Kredisë në lidhje me të cilën nuk është bërë Kërkesë Disbursimi në pajtim me nenin 1.02B do të anulohet automatikisht, pa asnjë njoftim të bërë nga Banka drejtuar Huamarrësit dhe pa detyrim të lindur në emër të ndonjë pale.

1.08 Shumat e kërkueshme sipas nenit 1

Shumat e kërkueshme sipas nenit 1.05 dhe 1.06 do të jenë të pagueshme në euro. Ato do të jenë të pagueshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja nga Huamarrësi e kërkesës së Bankës ose brenda një periudhe më të gjatë të specifikuar në kërkesën e Bankës.

Neni 2

Huaja

2.01 Shuma e Huas

Huaja do të përbëhet nga shuma përgjithshme e Transheve të disbursuara nga Banka sipas Kredisë, që konfirmohet nga Banka në pajtim me nenin 2.03.

2.02 Monedha e shlyerjes, interesit dhe detyrimeve të tjera

Interesi, shlyerjet dhe detyrimet e tjera të pagueshme në lidhje me çdo Transh dhe çdo pagesë tjetër do të bëhen në euro (EUR).

2.03 Konfirmimi nga Banka

Brenda 10 (dhjetë) ditësh pas Disbursimit të çdo Transhi, Banka do t'i paraqesë Huamarrësit tabelën e amortizimit të përmendur në nenin 4.01, sipas rastit, duke treguar Datën e Disbursimit, monedhën, shumën e disbursuar, termat e shlyerjes dhe normën e interesit për atë Transh.

Neni 3

Interesi

3.01 Norma e interesit

Normat Fikse dhe *Spread*-et janë të disponueshme për periudha jo më të shkurtra se 4 (katër) vjet ose, në mungesë të një shlyerjeje të principalit gjatë asaj periudhë, jo më të shkurtra se 3 (tre) vjet.

3.01A Transhe me normë fikse

Huamarrësi do të paguajë interes mbi balancën e mbetur të çdo Transhi me Normë Fikse me Normën



Fikse çdo tremujor, çdo gashëmujor ose çdo vit në fund të periudhës në Datat përkatëse të Pagesës, sipas specifikimit në Njoftimin e Disbursimit, e cila fillon në atë Datë Pagese të parë pas Datës së Disbursimit të Transhit. Nëse periudha nga Data e Disbursimit deri në Datën e parë të Pagesës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë ose më pak atëherë pagesa e interesit të mbledhur gjatë kësaj periudhe do të shtyhet deri në Datën pasuese të Pagesës.

Interesi do të llogaritet mbi bazën e nenit 5.01(a).

3.01B Transhe me Normë të Ndryshueshme

Huamarrësi do të paguajë interes mbi balancën e mbetur të çdo Transhi me Normë të Ndryshueshme me Normën e Ndryshueshme çdo tremujor, çdo gashëmujor ose çdo vit në fund të periudhës në Datat përkatëse të Pagesës, sipas specifikimit në Njoftimin e Disbursimit, e cila fillon në atë Datë Pagese të parë pas Datës së Disbursimit të Transhit. Nëse periudha nga Data e Disbursimit deri në Datën e parë të Pagesës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë ose më pak, atëherë pagesa e interesit të mbledhur gjatë kësaj periudhe do të shtyhet deri në Datën pasuese të Pagesës.

Banka do t'i njoftojë Huamarrësit Normën e Ndryshueshme brenda 10 (dhjetë) ditëve pas fillimit të çdo Periudhe Reference me Normë të Ndryshueshme.

Nëse në pajtim me nenet 1.05 dhe 1.06 disbursimi i çdo Transhi me Normë të Ndryshueshme ndodh pas Datës së Planifikuar të Disbursimit, Norma Përkatëse Ndërbankare e zbatueshme për Periudhën e parë të Referencës me Normë të Ndryshueshme do të zbatohet sikur disbursimi të ishte bërë në Datën e Planifikuar të Disbursimit.

Interesi do të llogaritet në lidhje me çdo Periudhë Reference me Normë të Ndryshueshme mbi bazën e nenit 5.01(b). Nëse Norma e Ndryshueshme për një Periudhë Reference të Normës së Ndryshueshme është nën zero, ajo do të caktohet zero.

3.02 Interesi mbi shumat e prapambetura

Pa cenuar nenin 10 dhe nëpërmjet përjashtimit të nenit 3.01, nëse Huamarrësi nuk paguan një shumë të kërkueshme prej tij sipas Kontratës në datën e kërkueshme, interesi do të mbledhet (në pajtim me dispozitat detyruese të ligjeve të zbatueshme, duke përfshirë nenin 1154 të kodit Civil të Luksemburgut) për çdo shumë të prapambetur të pagueshme sipas termave të kësaj Kontrate nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës faktike me një normë vjetor të barabartë me:

(i) për shumat e prapambetura në lidhje me Transhet me Normë të Ndryshueshme, Norma e Ndryshueshme e zbatueshme plus 2% (200 pikë bazë);

(ii) për shumat e prapambetura në lidhje me Transhet me Normë Fikse, më e larta e: a) Normave Fikse të zbatueshme plus 2% (200 pikë bazë); ose b) Norma Ndërbankare Përkatëse plus 2% (200 pikë bazë);

(iii) për shumat e prapambetura të ndryshme nga nën (i) ose (ii) më sipër, Norma Ndërbankare Përkatëse plus 2% (200 pikë bazë),

dhe do të jenë të pagueshme në pajtim me kërkesën e Bankës. Me synim përcaktimin e Normës Ndërbankare Përkatëse në lidhje me nenin 3.02, periudhat përkatëse brenda kuptimit të skedulit B do të jenë periudhat pasuese prej një muaji që fillojnë në datën e kërkueshme.

Nëse shumat e prapambetura është në një monedhë të ndryshme nga monedha e Huas, do të zbatohet norma vjetore e mëposhtme, që është norma përkatëse ndërbankare që mbahet përgjithësisht nga Banka për transaksionet në atë monedhë plus 2% (200 pikë bazë), llogaritur në pajtim me praktikën e tregut për këtë normë.

3.03 Ngjarja e Ndërprerjes së Tregut

Nëse në një moment pas lëshimit nga banka të Njoftimit të Disbursimit deri në datën që bie 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para Datës së Disbursimit të Planifikuar, ndodh një Ngjarje e Ndërprerjes së Tregut, Banka mund të njoftojë Huamarrësin që kjo dispozitë ka hyrë në fuqi. Në një rast të tillë, do të zbatohet rregulli i mëposhtëm.

Në rastin e një Transhi të Njoftuar norma e interesit të zbatueshëm për këtë Transh të Njoftuar deri në Datën e Maturimit do të jetë norma (e shprehur si normë përqindjeje në vit me bazë të ndryshueshme ose fikse që ofrohet fillimisht) që përcaktohet nga Banka të jetë kostoja e plotë për Bankën për fondin e Transhit përkatës bazuar në normën e zbatueshme të referencës të bankës që gjenerohet brendapërbrenda ose një metodë alternative për përcaktimin e normës të përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Banka. Huamarrësi do të ketë të drejtën të refuzojë me shkrim këtë disbursim brenda afatit të specifikuar në njoftim dhe do të përballojë detyrimet e shkaktuar si rezultat, sipas rastit, dhe në këtë rast Banka nuk do të realizojë disbursimin dhe Kredia përkatëse do të mbetet e disponueshme për disbursim sipas nenit 1.02B. Nëse Huamarrësi nuk refuzon disbursimin në kohë, palët



bien dakord që disbursimi dhe kushtet e tij janë tërësisht detyruese për palët.

Shtrirja ose Norma Fikse e njoftuar më parë nga Banka në Njoftimin e Disbursimit nuk do të vazhdojë të jetë i zbatueshëm.

Neni 4 Shlyerja

4.01 Shlyerja e zakonshme

4.01A Shlyerja me këste

a) Huamarrësi do të shlyej çdo Transh nëpërmjet kësteve në Datat e Pagesave të specifikuar në Njoftimin përkatës të Disbursimit në pajtim me termat e tabelës së amortizimit të dhënë në pajtim me nenin 2.03.

b) Çdo tabelë amortizimi do të përpilohet mbi bazën që:

(i) në rastin e një Transhi me Normë Fikse, shlyerja do të bëhet çdo vit, çdo gjashtë muaj ose tremujor me këste të barabarta të principalit ose kësteve konstante të principalit dhe interesit;

(ii) në rastin e një Transhi me Normë të Ndryshueshme, shlyerja do të bëhet me këste të barabarta vjetore, gjashtë-mujore ose tremujore të principalit;

(iii) data e parë e shlyerjes së çdo Transhi do të jetë Data e Pagesës që bie jo më parë se 60 ditë nga Data e Disbursimit të Planifikuar dhe jo më vonë se Data e parë e Pagesës menjëherë pas përvjetorit të 6-të (gjashtë) të Datës së Disbursimit të Planifikuar të Transhit; dhe

(iv) data e fundit e shlyerjes së çdo Transhi do të jetë një Datë Pageje që nuk bie më parë se 4 (katër) vjet dhe jo më vonë se 25 (njëzet e pesë) vjet nga Data e Disbursimit të Planifikuar.

4.01B Kësti i vetëm

Si alternativë, Huamarrësi mund të shlyej Transhin në një këst të vetëm në një Datë Pageje të specifikuar në Njoftimin e Disbursimit, që është data që bie jo më pak se 3 (tre) vjet ose më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet nga Data e Disbursimit të Planifikuar.

4.02 Parapagimi i vullnetshëm

4.02A Opsioni i parapagimit

Në pajtim me nenin 4.02B, 4.02C dhe 4.04, Huamarrësi mund të shlyej të gjithë ose një pjesë të një Transhi, së bashku me interesin e mbledhur dhe zhdëmtimet, sipas rastit, pas paraqitjes së një Kërkese Parapagimi me të paktën 1 (një) muaj afat paraprak duke specifikuar: (i) Shumën e Parapagimit, (ii) Datën

e Parapagimit, (iii) sipas rastit, zgjedhjen e metodës së aplikimit të shumës së Parapagimit në pajtim me nenin 5.05C(i); dhe iv) numrin e kontratës ("Fl nr") të përmendur në fletën përcjellëse të kësaj Kontrate.

Në pajtim me nenin 4.02C Kërkesa e Parapagimit është detyruese dhe e parevokueshme.

4.02B Zhdëmtimi i parapagimit

4.02B(1) TRANSHI ME NORMË FIKSE

Nëse Huamarrësi parapaguan një Transh me normë Fikse, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës, në Datën e Parapagimit, Zhdëmtimin e Parapagimit në lidhje me Transhin me Normë Fikse që parapaguhet.

4.02B(2) TRANSHI ME NORMË TË NDRYSHUESHME

Huamarrësi mund të parapaguajë Transhin me Normë të Ndryshueshme pa zhdëmtim në çdo Datë përkatëse të Pagesës.

4.02C Mënyra e funksionimit të parapagimit

Me paraqitjen nga Huamarrësi në Bankë të një Kërkese Parapagimi, Banka do të nxjerrë një Njoftim Parapagimi drejtuar Huamarrësit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para Datës së Parapagimit. Njoftimi i Parapagimit do të specifikojë Shumën e Parapagimit, interesin e mbledhur për këtë, Zhdëmtimin e Parapagimit të pagueshëm sipas nenit 4.02B ose, sipas rastit, kur nuk kërkohet zhdëmtim, metodën e aplikimit të Shumës së Parapagimit dhe Afatin e Pranimit.

Nëse Huamarrësi e pranon Njoftimin e Parapagimit jo më vonë se deri në Afatin e Pranimit, ai do të realizojë parapagimin. Në çdo rast tjetër, Huamarrësi mund të mos e bëjë parapagimin.

Huamarrësi do ta shoqërojë parapagimin me pagesën e interesit të mbledhur dhe zhdëmtimit, sipas rastit, të kërkueshëm për Shumën e Parapagimit, siç specifikohet në Njoftimin e Parapagimit.

4.03 Parapagimi i detyrueshëm

4.03A Ngjarjet e parapagimit

4.03A(1) ULJA E SHPENZIMEVE TË PROJEKTI

Nëse kostoja totale e Projektit bie poshtë shifrës së përcaktuar në paragrafin hyrës (2) dhe në këtë mënyrë shuma e Kredisë e kalon 50% (pesëdhjetë për qind) të kësaj kostoje totale, Banka mund menjëherë, me njoftim drejtuar Huamarrësit, të anulojë pjesën e padisbursuar të Kredisë dhe/ose të kërkojë parapagimin e Huas deri në shumën në të cilën Kredia e kalon 50% (pesëdhjetë për qind) të koston totale të Projektit. Huamarrësi do ta realizojë pagesën e shumës së kërkuar në datën e specifikuar nga



Banka, ku një datë e tillë është data që bie jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

4.03A(2) *PARI PASSU PËR FINANCIMIN JO TË BEI-t*

Nëse Huamarrësi vullnetarisht parapaguan (për mënjanimin e dyshimit, parapagimi do të përfshijë një riblerje ose anulim sipas rastit) një pjesë ose të gjithin e çdo financimi jo të BEI-t dhe ky parapagim nuk bëhet me fondet e një huaje ose gjendje tjetër borxhi që ka një afat të paktën të barabartë me afatin e paskaduar të parapagesës së financimit të ndryshëm nga të BEI-t, Banka, me njoftim drejtuar Huamarrësit, mund të anulojë pjesën e padisbursuar të Kredisë dhe të kërkojë parapagimin e Huas. Pjesa e Huas që Banka mund të kërkojë të parapaguhet do të jetë e njëjtë me raportin që shuma e parapaguar e financimit të ndryshëm nga të BEI-t ka me shumën e plotë të mbetur nga gjithë Financimi i ndryshëm nga i BEI-t.

Huamarrësi do ta realizojë pagesën e shumës së kërkuar në datën e specifikuar nga Banka, ku një datë e tillë është data që bie jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

Për qëllimet e këtij neni, “Financimi jo i BEI-t” përfshin çdo hua, (përveç Huas dhe çdo hua tjetër të drejtpërdrejtë nga Banka për Huamarrësin), obligacione kredie ose formë tjetër të qenies në borxh financiar apo çdo detyrim për pagesë ose shlyerje të parave që fillimisht i janë dhënë Huamarrësit për një afat prej jo më shumë se 3 (tre) vjet.

4.03A(3) *NDRYSHIMI I LIGJIT*

Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën nëse ka ndodhur ose mund të ndodhë një Ngjarje e Ndryshimit të Ligjit. Në një rast të tillë, ose nëse Banka ka shkak të arsyeshem për të besuar që një Ngjarje e Ndryshimit të Ligjit ka ndodhur ose mund të ndodhë, Banka mund t’i kërkojë Huamarrësit të konsultohet me të. Ky konsultim do të zhvillohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e kërkesës së Bankës. Nëse, pas kalimit të 30 (tridhjetë) ditëve nga data e një kërkesë të tillë për konsultim Banka është e mendimit që efektet e Ngjarjes së Ndryshimit të Ligjit nuk mund të lehtësohen në favorin e saj, Banka, nëpërmjet njoftimit drejtuar Huamarrësit, mund të anulojë pjesën e padisbursuar të Kredisë dhe të kërkojë parapagimin e Huas, së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të mbledhura dhe të pashlyera sipas kësaj Kontrate.

Huamarrësi do të realizojë pagesën e shumës së kërkuar në datën e specifikuar nga Banka, ku një datë

e tillë është data që bie jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë nga data e kërkesës.

Për qëllimet e këtij neni “Ngjarje e Ndryshimit të Ligjit” është çdo hyrje në fuqi, shpallje, nënshkrim apo ratifikim ose një ndryshim apo amendim i çdo ligji, rregulli apo rregulloreje (ose në aplikimin ose interpretimin zyrtar të ligjit, rregullit ose rregullores) që ndodh pas datës së kësaj Kontrate dhe që, në mendimin e Bankës, do të cenonte në masë të konsiderueshme aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate ose një garanci të dhënë në lidhje me këtë Kontratë.

4.03A(4) *PALIGJSHMËRIA*

Nëse në një juridiksion të zbatueshëm bëhet e paligjshme për Bankën të përmbushë ndonjë prej detyrimeve të saj siç parashikohet në këtë Kontratë ose të financojë apo mbajë Huan, Banka do të njoftojë menjëherë Huamarrësin dhe menjëherë mund të: (i) pezullojë ose anulojë pjesën e padisbursuar të Kredisë dhe/ose (ii) kërkojë parapagimin e Huas, së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të mbledhura dhe të pashlyera sipas kësaj Kontrate në datën e treguar nga Banka në njoftimin e saj drejtuar Huamarrësit.

4.03A(5) *SHPENZIMI KUALIFIKUES MË I VOGËL SE SHUMA E TRANSHIT*

Huamarrësi do të sigurojë që Zbatuesi do të:

(a) brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga disbursimi i një Transhi sipas saj, të bëjë Shpenzim Kualifikues në një shumë që është të paktën e barabartë me shumën e 80% (tetëdhjetë për qind) të shumës së atij Transhi dhe 100% (njëqind për qind) të shumave të të gjitha Transheve të disbursuar para tij, sipas rastit;

(b) brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga disbursimi i Transhit të fundit sipas saj, të bëjë Shpenzimin Kualifikues në një shumë që është të paktën e barabartë me shumën e 100% (njëqind për qind) të shumës së atij Transhi dhe 100% (njëqind për qind) të shumave të të gjitha Transheve të disbursuara para tij, sipas rastit.

Si provë e respektimit të detyrimeve të mësipërme, Huamarrësi do të paraqesë, ose do të sigurojë që Zbatuesi të paraqesë, në një mënyrë të pranueshme për Bankën, dokumente në anglisht ose të shoqëruara nga një përkthim në gjuhën angleze.

Nëse në lidhje me një Transh të disbursuar, Huamarrësi nuk arrin të paraqesë ose sigurojë që Zbatuesi t’i paraqesë Bankës një prej dokumenteve të



përmendura në këtë Nen 4.03A(5) deri në datat e tyre përkatëse të kërkueshme, Banka mund të kërkojë parapagimin e pjesës së Transhit që kalon shumën e Shpenzimit Kualifikues të bërë nga Huamarrësi në lidhje me të cilën Huamarrësi ka dhënë prova të pranueshme për Bankën.

4.03B Mënyra e parapagimit

Çdo shumë e kërkuar nga Banka në pajtim me nenin 4.03A, së bashku me çdo interes ose shuma të tjera të mbledhura ose të pashlyera sipas kësaj Kontrate duke përfshirë, pa kufizim, çdo zhdëmtim të kërkueshëm sipas nenit 4.03C dhe nenit 4.04, do të paguhet në datën e treguar nga Banka në njoftimin e saj të kërkesës.

4.03C Zhdëmtimi i parapagimit

Në rastin e një Ngjarjeje të Zhdëmtimit të Parapagimit, zhdëmtimi, sipas rastit, paguhet në pajtim me nenin 4.02B.

4.04 Të përgjithshme

Një shumë e shlyer ose e parapaguar nuk mund të rimerret hua. Ky nen 4 nuk do të cenohet nën 10.

Nëse Huamarrësi parapaguan një Transh në një datë të ndryshme nga një Datë përkatëse Pagese, Huamarrësi do të zhdëmtojë Bankën në atë shumë që Banka do të certifikojë që kërkohet për ta kompensuar atë për marrjen e fondeve ndryshe nga në një Datë përkatëse Pagese.

Neni 5 Pagesat

5.01 Rregulli i llogaritjes së ditëve

Çdo shumë e kërkueshme si interes, zhdëmtim ose tarifë nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate dhe e llogaritur në lidhje me një pjesë të vitit, do të përcaktohet në mënyrat përkatëse të mëposhtme:

- a) në lidhje me interesin dhe zhdëmtimet e kërkueshme sipas një Transhi me Normë Fikse, një vit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë dhe një muaj me 30 (tridhjetë) ditë;
- b) në lidhje me interesin dhe zhdëmtimet e kërkueshme sipas një Transhi me Normë të Ndryshueshme, një vit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë dhe numri i ditëve të kaluara;
- c) në lidhje me tarifën, një vit me 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë dhe numri i ditëve të kaluara.

5.02 Koha dhe vendi i pagesës

Përveç kur specifikohet ndryshe në këtë Kontratë ose në kërkesën e Bankës, të gjitha shumat të ndryshme nga shumat e interesit, zhdëmtimit dhe principalit janë të pagueshme brenda 15 (pesëmbë-

dhjetë) ditëve nga marrja nga Huamarrësi të kërkesës së Bankës.

Çdo shumë e pagueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate do të paguhet në llogarinë përkatëse të njoftuar nga Banka Huamarrësit. Banka do të njoftojë llogarinë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së kërkueshme për pagesën e parë nga Huamarrësi dhe do të njoftojë çdo ndryshim llogarie jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së pagesës së parë për të cilën zbatohet ndryshimi. Ky afat njoftimi nuk zbatohet në rastin e pagesës sipas nenit 10.

Huamarrësi do të tregojë në çdo pagesë të bërë sipas kësaj numrin e kontratës (“Nr. FI”) që gjendet në faqen e parë të kësaj Kontrate.

Një shumë që është e kërkueshme nga Huamarrësi do të konsiderohet e paguar kur Banka e merr atë.

Të gjitha Disbursimet dhe pagesat e Bankës sipas kësaj Kontrate do të bëhen duke përdorur llogarinë(të) e pranueshme për Bankën. Për mënyrën e dyshimit, çdo llogari në emrin e Huamarrësit që mbahet në një institucion financiar të autorizuar rregullisht në juridiksionin ku është themeluar Huamarrësi ose ku ndërmerret Projekti konsiderohet të jetë e pranueshme për Bankën.

5.03 *Set-off* (E drejta e Bankës për konfiskimin e gjendjes së llogarisë së klientit për ta përdorur për detyrimet)

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate do të llogariten dhe bëhen pa *sett-off* ose kundërkërkesë (dhe të lira nga çdo zbritje e tillë).

5.04 Ndërprerja e sistemeve të pagesave

Nëse Banka përcakton (në diskrecionin e saj) që ka ndodhur një Ngjarje Ndërprerjeje ose Banka njoftohet nga Huamarrësi që ka ndodhur një Ngjarje Ndërprerjeje:

a) Banka mund, dhe nëse i kërkohet ta bëjë këtë nga Huamarrësi, të konsultohet me Huamarrësin me synim rënien dakord me Huamarrësin për ato ndryshime në operimin ose administrimin e Kontratës që Banka mund t'i konsiderojë të nevojshme sipas rrethanave;

b) Banka nuk është e detyruar të konsultohet me Huamarrësin në lidhje me ndonjë ndryshim të përmendur në paragrafin (a) nëse, sipas mendimit të saj, nuk është e praktike për ta bërë këtë sipas rrethanave dhe, në çdo rrethanë, nuk do të ketë asnjë detyrim të bjerë dakord me këto ndryshime; dhe

c) Banka nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë zhdëmtim, kosto, humbje të çfarëdo lloji si rezultat i



një Ngjarjeje Ndërprerjeje ose për marrjen ose mosmarrjen e ndonjë veprimi në pajtim ose në lidhje me këtë nen 5.04.

5.05 Aplikimi i shumave të marra

a) Të përgjithshme

Shumat e marra nga Huamarrësi do të shlyejnë vetëm detyrimet e tij për pagesë nëse merren në pajtim me termat e kësaj Kontrate.

b) Pagesa të pjesshme

Nëse Banka merr një pagesë që nuk është e mjaftueshme për të shlyer të gjitha shumat që janë të kërkueshme dhe të pagueshme nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate, Banka do të aplikojë këtë pagesë:

(i) së pari, në ose drejt pagesës proporcionale të çdo tarife, kostoje, zhdëmtimi dhe shpenzimi të papaguar dhe të kërkueshëm sipas kësaj Kontrate;

(ii) së dyti, në ose drejt pagesës së çdo interesi të mbledhur të kërkueshëm por të papaguar sipas kësaj Kontrate;

(iii) së treti, në ose drejt pagesës së një principali të kërkueshëm, por të papaguar sipas kësaj Kontrate; dhe

(iv) së katërti, në ose drejt pagesës së çdo shume tjetër të kërkueshme por të papaguar sipas kësaj Kontrate.

c) Alokimi i shumave në lidhje me Transhet

(i) Në rastin e:

- një parapagese të pjesshme vullnetare të një Transhi që i nënshtrohet një shlyerjeje në disa këste, Shuma e Parapagimit do të aplikohet proporcionalisht për çdo këst të pashlyer, ose, me kërkesën e Huamarrësit, në rendin e anasjellë të maturimit,

- një parapagese të pjesshme vullnetare të një Transhi që i nënshtrohet një shlyerjeje në disa këste, Shuma e Parapagimit do të aplikohet në zbritje të kësteve të prapambetur në rendin e anasjelltë të maturimit.

(ii) Shumat e marra nga Banka pas një kërkesë sipas nenit 10.01 dhe që aplikohet për një Transh, do t'i zbresin këstet e pashlyera në rendin e anasjelltë të maturimit. Banka mund të aplikojë shumat e mara ndërmjet Transheve sipas diskrecionit të saj.

(iii) Në rastin e marrjes së shumave, të cilat nuk mund të identifikohen si të aplikueshme për një Trash të caktuar dhe për të cilat nuk ka marrëveshje ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit për aplikimin e tyre, Banka mund t'i aplikojë këto ndërmjet Transheve sipas diskrecionit të saj.

Neni 6

Angazhimet e Huamarrësit dhe përfaqësimet

Angazhimet e këtij neni 6 mbeten në fuqi nga data e kësaj Kontrate për sa kohë që çdo shumë sipas kësaj Kontrate nuk është shlyer ose Kredia është në fuqi.

A. Angazhimet e Projektit

6.01 Përdorimi i Huas dhe disponueshmëria e fondeve të tjera

Huamarrësi do të përdorë, dhe do të garantojë që Zbatuesi të përdorë, të gjitha shumat e marra hua prej tij sipas kësaj Huaje për zbatimin e Projektit.

Huamarrësi do të sigurojë që ai ka të disponueshme të gjitha fondet e tjera të renditura në paragrafin hyrës (2) dhe që këto fonde shpenzohen, në masën e kërkuar, për financimin e Projektit.

6.02 Përfundimi i Projektit

Huamarrësi do të sigurojë që Zbatuesi ta përmbushë Projektin në pajtim me Përshkrimin Teknik që mund të ndryshohet herë pas here me aprovimin e Bankës, dhe ta përfundojë atë brenda datës përfundimtare të përcaktuar aty.

6.03 Kostoja e shtuar e Projektit

Nëse kostoja totale e Projektit e kalon shifrën e treguar në paragrafin hyrës (2), Huamarrësi do ta përftojë financimin për të financuar koston shtesë pa iu drejtuar Bankës, për të mundësuar që Projekti të përfundojë në pajtim me Përshkrimin Teknik. Planet për të financuar koston shtesë do t'i komunikohen Bankës pa vonesë.

6.04 Procedura e prokurimit

Huamarrësi merr përsipër të prokurojë, gjithashtu nëpërmjet Zbatuesit, të blejë pajisjet, të sigurojë shërbimet dhe të porosisë punët për Projektin me procedua të pranueshme që të jenë të pranueshme për Bankën me politikën e saj të përshkruar në Udhëzimin për Prokurimin.

6.05 Angazhimet në vazhdim të Projektit

Huamarrësi do të sigurojë që Huamarrësi:

a) Mirëmbajtja: ruan, riparon, mirëmban dhe rinovon të gjitha sendet pasurore që janë pjesë e Projektit që kërkojnë për ta mbajtur atë në gjendje të mirë funksionale:

b) Sendet pasurore të Projektit: (përveç kur Banka ka dhënë pëlqimin e saj paraprak me shkrim) ruan titullin dhe zotërimin e të gjithë ose thelbësisht të gjithë sendeve pasurore që përbëjnë Projektin ose, sipas rastit, zëvendëson dhe rinovon këto sende pasurore dhe e mban Projektin në operacion thelbësisht të



vazhdueshëm në pajtim me qëllimin e tij original; me kusht që Banka mund të mos e japë pëlqimin e saj vetëm nëse veprimi i propozuar do të cenonte interesat e Bankës si Huadhënës për Huamarrësin ose do ta bënte Projektin të papërshtatshëm për financimin nga Banka sipas Statutit të saj ose sipas nenit 309 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian;

c) Sigurimi: siguron të gjitha punët dhe pronën që përbën pjesë të Projektit me shoqëri të klasit të parë në pajtim me praktikën më të plotë përkatëse të industrisë;

d) Të drejtat e dhe lejet: mban në fuqi të gjitha të drejtat e kalimit ose përdorimit dhe të gjitha autorizimet e nevojshme për ekzekutimin dhe operimin e Projektit; dhe

e) Shqetësimet mjedisore dhe sociale:

(i) e zbaton dhe operon projektin në pajtim me ligjin mjedisor dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale; dhe

(ii) merr, mban dhe respekton Aprovimet Mjedisore dhe Sociale për Projektin.

f) Ligji i BE-së: ekzekuton dhe operon Projektin në pajtim me ligjet përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe standardet përkatëse të ligjit të BE-së, përveç ndonjë shmangieje të përgjithshme të bërë nga Bashkimi Europian;

g) Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social: zbaton projektin në pajtim me Planin e Menaxhimit Mjedisor dhe Social;

h) Plani i Veprimit të Rivendosjes: zbaton Planin e Veprimit të Rivendosjes dhe Projektin në përputhje me Planin e Veprimit të Rivendosjes;

i) Plani Operacional dhe i Mirëmbajtjes: 3 (tre) muaj para vënies në funksionim të Projektit, përgatit një plan operimi dhe mirëmbajtjeje për rrugën, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën, dhe pastaj vazhdon me zbatimin e këtij plani deri në maturimin e Huas; dhe

j) Palët përkatëse: nuk hyn në asnjë transaksion me ndonjë palë në kontekstin e Projektit dhe të gjitha transaksionet në lidhje me Projektin lidhen brenda mundësisë dhe në përpushje me termat tregtarë.

B. Angazhime të përgjithshme

6.06 Përputhshmëria me ligjet

Huamarrësi do të përmbushë dhe siguron që Zbatuesi të respektojë në të gjitha aspektet të gjitha ligjet dhe rregulloret që ai ose Projekti u nënshtrohet.

6.07 Librat dhe regjistrat

Huamarrësi do të garantojë që (nëse dhe në masën e zbatueshme), dhe do të garantojë që Zbatuesi:

a) ka mbajtur dhe vazhdon të mbajë libra dhe regjistra të rregullt llogarish, në të cilat bëhen hyrje të plota dhe të sakta për të gjitha transaksionet financiare dhe sendet pasurore dhe biznesi i Zbatuesit, duke përfshirë shpenzimet në lidhje me Projektin, në pajtim me GAAP-in (nëse është i zbatueshëm), që janë në fuqi herë pas here; dhe

b) mban regjistra të kontratave të financuara nga shumat e Huas, duke përfshirë një kopje të vetë kontratës dhe dokumentet e rëndësishme në lidhje me prokurimin për të paktën 6 vjet nga përmbushja thelbësore e kontratës.

6.08 Integriteti

a) Sjellja e ndaluar:

(i) Huamarrësi nuk do të angazhohet dhe merr masa që edhe Zbatuesi të mos angazhohet (dhe nuk do të autorizojë apo lejojë një Person tjetër të veprojë në emër të tyre për t'u angazhuar) në një Sjellje të Ndaluar në lidhje me Projektin, ndonjë procedurë tenderimi për Projektin, ose një transaksion të parashikuar nga Kontrata ose Dokumentet e Projektit.

(ii) Huamarrësi merr përsipër, dhe do të garantojë që Zbatuesi, do të ndër marrë ato veprime që Banka do t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të hetuar ose ndërprerë një ndodhi të pretenduar ose dyshuar të një Sjelljeje të Ndaluar në lidhje me Projektin.

(iii) Huamarrësi merr përsipër, dhe do të garantojë që Zbatuesi do të sigurojë që kontratat e financuara nga kjo Hua të përfshijnë dispozitat e nevojshme për t'i mundësuar Huamarrësit të hetojë ose ndërpresë çdo ndodhi të pretenduar ose dyshuar të një Sjelljeje të Ndaluar në lidhje me Projektin.

b) Sanksionet: Huamarrësi nuk do të, do të garantojë që Zbatuesi nuk do të: (i) lidhë një marrëdhënie biznesi me ndonjë Person të Sanksionuar, ose (ii) ofrojë fonde për përfitimin, drejtpërdrejt ose jo, të një Personi të Sanksionuar;

c) Menaxhimi i Huamarrësit ose Zbatuesit: Huamarrësi merr për sipër, dhe do të sigurojë që Zbatuesi do të marrë, brenda një afati të arsyeshëm masa të përshtatshme në masën e lejuar nga ligji i zbatueshëm në lidhje me një anëtar të organeve vendimmarrëse të tij që:

(i) bëhet një Person i Sanksionuar; ose

(ii) i nënshtrohet një vendimi përfundimtar dhe të parevokueshëm në lidhje me Sjelljen e Ndaluar të kryer në ushtrimin e detyrave të tyre profesionale, me synim garantimin që një anëtar i tillë të pezullohet,



pushohet ose në çdo rast përjashtohet nga çdo aktivitet i Huamarrësit ose Zbatuesit në lidhje me Huan dhe Projektin.

Huamarrësi garanton që ai dhe Zbatuesi nuk kanë kryer dhe asnjë person sipas dijenisë së tyre të tashme nuk ka kryer ndonjë prej veprimeve të përshkruara në nenin 6.08.

Për këtë qëllim, dijenia e çdo ministri të Huamarrësit, çdo Sekretari Shteti të Huamarrësit, ndonjë asistenti të Ministrit të Huamarrësit, çdo Këshilltari të një Ministri të Huamarrësit, menaxheri ose anëtar personeli i Huamarrësit do të konsiderohet të jetë dijeni të Huamarrësit. Huamarrësi do të informojë dhe do të marrë masa që Zbatuesit të njoftojë Bankën nëse ajo duhet të marrë dijeni të një fakti ose informacioni që tregon kryerjen e një veprimi të tillë.

6.09 Përfaqësime të përgjithshme dhe garanci

Huamarrësi përfaqëson dhe i garanton Bakës që:

a) ai ka kompetencën të nënshkruajë, të shpallë dhe të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe të gjitha masat e tjera të nevojshme korporative, aksionare dhe të tjera janë ndërmarrë për nënshkrimin, shpalljen dhe përmbushjen e tyre prej tij;

b) kjo Kontratë përbën detyrimet e tij ligjërish të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme;

c) nënshkrimi dhe shpallja e përmbushjes së detyrimeve sipas dhe në pajtim me dispozitat e kësaj Kontrate nuk janë dhe:

(i) nuk do të jenë në kundërshtim ose konflikt me ligjin, statutin, rregullin ose rregulloren apo ndonjë vendim, dekret apo leje të zbatueshme që ai i nënshtrohet;

(ii) nuk do të jenë në kundërshtim ose konflikt me ndonjë marrëveshje ose instrument tjetër detyrues për të që mund të pritet normalisht të ketë një efekt të konsiderueshëm negativ mbi aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Kontrate;

d) nuk ka pasur Ndryshim Material të Pafavorshëm;

e) nuk ka ndodhur asnjë ngjarje ose rrethanë që përbën një Rast të Mosplotësimit të Detyrimeve dhe nuk po vazhdon e pandrequr ose pa hequr dorë;

f) asnjë gjykim, arbitrazh, procedim administrativ ose hetim nuk po zhvillohet apo në dijeninë e tij rrezikon të zhvillohet ose është i papërfunduar në gjykatë, gjykatë arbitrazhi apo agjenci e cila ka rezultuar, apo që nëse vendos në mënyrë të pafavorshme, normalisht mund të rezultojë në një Ndryshim Material të Pafavorshëm, dhe nuk ekziston ndaj tij apo filialeve të tij asnjë vendim apo shpërblim në disfavor;

g) ai ka marrë të gjitha autorizimet e nevojshme në lidhje me këtë Kontratë dhe me synim përmbushjen e ligjshme të detyrimeve të tij sipas saj, dhe Projekti dhe të gjitha autorizimet janë në fuqi të plotë dhe të pranueshme në prova;

h) detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj Kontrate renditen *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tashme dhe të ardhshme, të garantuara dhe të pavarura sipas ndonjë prej instrumenteve të tij të borxhit, përveç detyrimeve detyrimisht preferenciale me ligj të zbatueshme përgjithësisht për shoqëritë;

i) ai dhe/ose Zbatuesi është në pajtim me nenin 6.05(e) dhe në dijeninë dhe besimin e tij të plotë (duke bërë hetime të kujdesshme dhe të duhura) asnjë Pretendim Mjedisor ose Social nuk është ngritur apo rrezikon të ngrihet ndaj tij;

j) ai është pronari i vetëm ligjor dhe përfitues dhe ka titull të potë mbi sendet pasurore në lidhje me Projektin në datën e Kontratës, dhe nuk ka garanci mbi sendet e tij pasurore;

k) është në pajtim me të gjitha angazhimet sipas nenit 6;

l) Zbatuesi dhe Ekipi i Zbatimit të Projektit janë tërësisht funksionale dhe operacionale, duke pasur të gjitha të drejtat dhe lejet e nevojshme për të zbatuar Projektin;

m) sipas dijenisë së tij të plotë, asnjë fond i investuar në Projekt nga Huamarrësi ose Zbatuesi nuk është me origjinë të paligjshme, duke përfshirë produktet e Pastrimit të Parave ose të lidhura me Financimin e Terrorizmit;

n) as Huamarrësi dhe as Zbatuesi, punonjësit dhe drejtorët e tij dhe asnjë person tjetër që vepron në emër të tij ose të tyre ose është nën kontrollin e tij ose të tyre nuk ka kryer dhe nuk do të kryejë: i) një Sjellje të Ndaluar në lidhje me Projektin ose një transaksion të parashikuar në Kontratë ose Dokumentet e Projektit; ose ii) ndonjë aktivitet ilegal në lidhje me Financimin e Terrorizmit ose Pastrimin e Parave; dhe

o) Projekti (duke përfshirë pa kufizim, negocimin, dhënie dhe përmbushjen e kontratave të financuara ose që do të financohen nga Huaja) nuk ka pasur të bëjë apo dhënë shkak për Sjellje të Ndaluar.

Përfaqësimet dhe garancitë e parashikuara më sipër do të mbeten në fuqi pas përmbushjes së kësaj Kontrate dhe, me përjashtimet e përfaqësimit të parashikuar në paragrafin (f) më sipër, konsiderohet të përsëritet në çdo Disbursim, Datë Disbursimi dhe në çdo Datë Pagine.



Neni 7 Garancia

7.01 Renditja *pari passu*

Huamarrësi do të garantojë që detyrimet e tij të pagesës sipas kësaj Kontrate renditen dhe do të renditen, jo më poshtë se *pari passu* në të drejtën e pagesës me të gjitha detyrimet e tjera të tashme dhe të ardhme të pasiguruara dhe të pavarura sipas ndonjë prej Instrumenteve të tij të Jashtëme të Borxhit.

Në mënyrë të veçantë, nëse Banka bën një kërkesë sipas nenit 10.01 ose nëse një ngjarje ose rast mosplotësimi i detyrimeve sipas ndonjë prej Instrumenteve të tij të Jashtëm të Borxhit të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit ose të një prej agjencive apo instrumenteve të tij ka ndodhur dhe vazhdon, Huamarrësi nuk do të kryejë (apo autorizojë) asnjë pagesë në lidhje me ndonjë Instrument tjetër të tillë të tij të Jashtëm të Borxhit (të planifikuar rregullisht apo ndryshe) pa paguar njëkohësisht, ose vendosur mënjane në një llogari të destinuar për pagesën në Datën pasuese të Pagesës të një shume të barabartë në të njëjtin raport të borxhit të papaguar sipas kësaj Kontrate si raporti që ka një pagesë sipas këtij Instrumenti të Jashtëm të Borxhit ndaj borxhit total të papaguar sipas atij Instrumenti. Për këtë synim, çdo pagesë e një Instrumenti të Jashtëm Borxhi që bëhet nga shumata e lëshuara nga një instrument tjetër, tek të cilët janë nënshkruar të njëjtët persona si zotërues të pretendimeve sipas Instrumentit të Jashtëm të Borxhit, nuk do të merret parasysh.

Në këtë Kontratë, “Instrument i Jashtëm Borxhi” është: a) një instrument, duke përfshirë çdo marrje ose pasqyrë llogarish, që provon se përbën një detyrim për të shlyer një hua, depozitë, parapagim ose shtrirje të ngjashme të kredisë (duke përfshirë pa kufizim çdo shtrirje të kredisë sipas një marrëveshjeje rifinancimi ose riskedulimi); b) një detyrim të provuar nga një obligacion, dëftesë borxhi ose provë e ngjashme me shkrim të qenies në borxh; ose c) një garanci e dhënë nga Huamarrësi për një detyrim të një pale të tretë, me kusht që në çdo rast ky detyrim është: i) i rregulluar nga një sistem ligjor i ndryshëm nga ai i ligjit të Huamarrësit; ose ii) i pagueshëm në një monedhë të ndryshme nga monedha e vendit të Huamarrësit; ose iii) i pagueshëm një personi të themeluar, me vendbanim rezident ose me selinë e tij kryesore ose vendin kryesor të aktivitetit jashtë vendit të Huamarrësit.

7.02 Garanci shtesë

Nëse Huamarrësi i jep një pale të tretë një garanci për përmbushjen e një Instrumenti të Jashtëm Borxhi ose një preferencë apo prioritet në lidhje me të, Huamarrësi, nëse kjo kërkohet nga Banka, do t'i japë Bankës të njëjtën garanci për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate ose i jep Bankës preferencë ose prioritet të barasvlershëm.

7.03 Dispozitat e përfshirjes

Nëse Huamarrësi lidh një marrëveshje financimi me një kreditor tjetër financiar afatmesëm ose afatgjatë që përfshin një dispozitë për humbjen e vlerësimit, dhe/ose dispozitë deklarimi paaftësie paguese dhe/ose një dispozitë *pari passu* ose një detyrim apo dispozitë në lidhje me raportet e tij financiare që nuk është parashikuar në këtë Kontratë ose që është më e favorshme për kreditorin përkatës financiar të ndryshme nga dispozitat e barasvlershme në këtë Kontratë për Bankën, Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën dhe do t'i paraqesë Bankës një kopje të dispozitës më të favorshme.

Banka mund të kërkojë që Huamarrësi të nënshkruajë menjëherë një marrëveshje për të ndryshuar këtë Kontratë për të parashikuar një dispozitë të barasvlershme në favor të Bankës.

Neni 8

Informacioni dhe vizitat

8.01 Informacioni në lidhje me Projektin

Huamarrësi do të garantojë ose do të garantojë që Zbatuesi do t'i:

a) dorëzojë Bankës:

(i) informacionin në përmbajtje dhe formë, dhe kohën, e specifikuar në skedulën A.2 ose siç është rënë dakord ndryshe here pas here nga Palët në këtë Kontratë; dhe

(ii) çdo informacion ose dokument tjetër në lidhje me financimin, prokurimin, zbatimin, operimin dhe çështjet mjedisore të dhe për Projektin që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshëm brenda një afati të arsyeshëm,

në çdo rast me kusht që nëse ky informacion ose dokument nuk i paraqitet Bankës në kohë dhe Huamarrësi nuk e korrigjon këtë mosveprim brenda një afati kohe të arsyeshëm të caktuar nga Banka me shkrim, Banka mund të korrigjojë mangësinë, në masën e mundshme, nëpërmjet angazhimit të personelit të saj ose të një konsulenti ose një pale të tretë, me shpenzimet e Huamarrësit dhe Huamarrësi do t'u ofrojë këtyre personave dhe të gjithë asistencën e nevojshme për këtë qëllim;



b) paraqesë për aprovim Bankës pa vonesë çdo ndryshim të konsiderueshëm në Projektin, duke marrë parasysh gjithashtu deklaratimet e bëra Bankës në lidhje me Projektin para nënshkrimit të Kontratës, në lidhje me, ndër të tjera, çmimin, projektimin, planet, planifikimin kohor ose programin e shpenzimeve ose planin e financimit për Projektin;

c) njoftojë menjëherë Bankën për:

(i) çdo padi ose protestë apo ndonjë kundërshtim të ngritur nga një palë e tretë ose një ankim i mirëfilltë i marrë nga Huamarrësi ose një Pretendim Mjedisor që sipas dijenisë së tij është ngritur, është në proces ose rrezikohet ndaj tij në lidhje me çështjet mjedisore ose të tjera që cenojnë Projektin;

(ii) çdo fakt ose ngjarje të njohur për Huamarrësin, që mund të cenojë në thelb ose ndikojë tek kushtet e zbatimit ose operimit të Projektit;

(iii) çdo mospërputhje prej tij me Standardet Mjedisore dhe Sociale;

(iv) çdo pezullim, revokim ose ndryshim i ndonjë Aprovimi Mjedisor ose Social;

(v) një pretendim ose ankim të mirëfilltë në lidhje me Sjelljen e Ndaluar në lidhje me Projektin; dhe

(vi) nëse ai vihet në dijeni të një fakti ose informacioni që konfirmon ose sugjeron në mënyrë të arsyeshme që: (a) një Sjellje e Ndaluar ka ndodhur në lidhje me Projektin; ose (b) një pjesë e fondeve të investuara në kapitalin e tij aksionar ose në Projekt ka ardhur nga një origjinë e paligjshme,

dhe përcakton veprimin që duhet ndërmarrë në lidhje me këto çështje.

d) paraqesë Bankës, nëse kërkohet:

(i) një certifikatë të siguruesve të tij që tregon përmbushjen e kërkesave të nenit 6,05(c);

(ii) çdo vit, një listë policash në fuqi që mbulojnë pasuritë e siguruara që përbëjnë pjesë të Projektit, së bashku me konfirmimin e pagesës së primeve të tashme; dhe

(iii) kopje të vërteta të kontratave të financuara me fondet e Huas dhe prova të shpenzimeve në lidhje me disbursimet.

8.02 Informacioni në lidhje me Huamarrësin

Huamarrësi do të, ose do të garantojë që Zbatuesi do të:

a) dorëzojë Bankës:

i) sapo të jenë të disponueshme por në çdo rast 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë pas përfundimit të secilit prej viteve të tij financiar raportin vjetor të konsoliduar dhe të pakonsoliduar të audituar të Zbatuesit, bilancin, llogarinë e fitimeve dhe humbjeve

dhe raportin e auditëve për atë vit financiar; dhe

ii) sapo të jenë të disponueshme publikisht por në çdo rast 120 (njëqind e njëzetë) ditë pas përfundimit të çdo periudhe kontabiliteti përkatës raportin e përkohshëm të konsoliduar dhe të pakonsoliduar gjashtë-mujor të Zbatuesit, bilancin, llogarinë e fitimeve dhe humbjeve dhe raportin e parë gjashtë-mujor; dhe

iii) herë pas here, atë informacion mbi situatën e përgjithshme financiare të Huamarrësit ose Zbatuesit që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme ose ato certifikata të përmbushjes së angazhimeve sipas nenit 6 që Banka mund ta çmojë të nevojshme; dhe

b) informon Bankën menjëherë për:

(i) çdo fakt që e detyron atë të parapaguajë ndonjë borxh financiar ose një financim të Bashkimit Europian;

(ii) çdo ngjarje ose vendim që përbën ose mund të rezultojë në një Ngjarje Parapagimi;

(iii) çdo synim nga ana e tij për të dhënë një garanci për një send pasuror në favor të një pale të tretë ose të lidhë një marrëveshje të tipit të përshkruar në nenin 7;

(iv) çdo synim nga ana e tij ose e Zbatuesit për të hequr dorë nga pronësia e një komponenti të konsiderueshëm të Projektit;

(v) çdo fakt ose ngjarje që mund të pengojë përmbushjen thelbësore të ndonjë detyrimi të Huamarrësit sipas kësaj Kontrate;

(vi) çdo ngjarje të renditur në nenin 10.01 që ka ndodhur ose kërcënon të ndodhë ose që pritet të ndodhë;

(vii) çdo fakt ose ngjarje që rezultojnë në: (a) një anëtar i organeve të menaxhimit; ose (b) një prej subjekteve të tij kontrolluese është Person i Sanksionuar;

(viii) në masën e lejuar nga ligji, çdo gjykim, arbitrazh, procedim administrativ ose hetim i rëndësishëm në lidhje me Sjelljen e Ndaluar dhe që zhvillohet nga një gjykatë, administratë apo autoritet i ngjashëm publik, i cili, sipas dijenisë dhe besimit të tij më të plotë, është faktik, i afërt ose i papërfunduar ndaj Huamarrësit ose PEP në lidhje me Huan ose Projektin;

(ix) çdo masë e marrë nga Huamarrësi në pajtim me nenin 6.08 të kësaj Kontrate, ose

(x) çdo gjykim, arbitrazh ose procedim administrativ apo hetim i cili është i faktik, i mundshëm ose i mbetur pezull dhe që, nëse vendoset në mënyrë të pafavorshme, mund të rezultojë në një Ndryshim Material të Pafavorshëm.

8.03 Vizitat nga Banka

a) Huamarrësi do të, dhe do të garantojë që Zbatuesi do të, lejojë të gjithë personat e caktuar nga Banka, si dhe personat e caktuar nga institucionet e



tjera të BE-së duke përfshirë Gjykatën e Auditëve të Komuniteteve Europiane, Komisionit Europian dhe Zyrës Europiane Antimashtrim:

(i) të vizitojnë vendet, instalimet dhe punët që përbëjnë Projektin dhe për të bërë ato kontrolle që ata mund të dëshirojnë për qëllimet e lidhura me Kontratën dhe financimin e Projektit,

(ii) të intervistojnë përfaqësuesit e Huamarrësit dhe/ose Zbatuesit dhe të mos pengojnë kontaktet me çdo person tjetër të përfshirë ose të ndikuar nga Projekti; dhe

(iii) të rishikojnë librat dhe regjistrat e Zbatuesit në lidhje me ekzekutimin e Projektit dhe të jenë në gjendje të marrin kopje të dokumenteve përkatës në masën e lejuar nga ligji.

(b) të Huamarrësi do të, ose do të garantojë që Zbatuesi do të, lehtësojë hetimet e Bankës ose institucionet apo organet e tjera kompetente të Bashkimit Europian në lidhje me një ndodhi të pretenduar ose dyshuar të një Sjelljeje të Ndaluar dhe i paraqet Bankës ose do të marrë masa që Bankës t'i jepet e gjithë asistencë e nevojshme për synimet e përshkruara në këtë nen.

(c) të Huamarrësi njuh, dhe do të garantojë që Zbatuesi të njohë, që Banka mund të jetë e detyruar të komunikojë informacion në lidhje me Huamarrësin, Zbatuesin dhe Projektin tek çdo institucion ose organ kompetent i Bashkimit Europian duke përfshirë Gjykatën e Auditëve të Komuniteteve Europiane, Komisionin Europian dhe Zyrën Europiane AntiMashtrim që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrës së tyre në pajtim me ligjet e Komuniteteve Europiane në pajtim me dispozitat përkatëse detyruese të së drejtës së Bashkimit Europian.

Neni 9

Detyrime dhe shpenzime

9.01 Taksat, detyrimet dhe tarifet

Huamarrësi do të paguajë të gjitha taksat, detyrimet, tarifet dhe pagesat e tjera të çdo natyre, duke përfshirë detyrimin e pullës dhe tarifet e regjistrimit, që rrjedhin nga nënshkrimi ose zbatimi i kësaj Kontrate ose çdo dokumenti përkatës në krijimin, përsosjen, regjistrimin ose ekzekutimin e një garancie të Huas në masën e zbatueshme.

Huamarrësi do të paguajë principalin, interesin, zhdëmtimet dhe shumat e tjera të kërkueshme sipas kësaj Kontrate bruto pa zbritur asnjë detyrim kombëtar apo lokal çfarëdo, me kusht që, nëse

Huamarrësi është i detyruar të bëjë këto zbritje, ai do të shtojë pagesën për Bankën në mënyrë që pas zbritjes, shumata neto e marrë nga Banka të jetë e barabartë me shumën e kërkueshme.

9.02 Detyrime të tjera

Huamarrësi do të mbulojë të gjitha detyrimet dhe shpenzimet, duke përfshirë detyrimet profesionale, bankare ose të këmbimit të shkaktuara në lidhje me nënshkrimin, zbatimin, ekzekutimin dhe prishjen e kësaj Kontrate ose çdo dokument tjetër përkatës, çdo ndryshim, shtesë ose heqje dorë në lidhje me këtë Kontratë ose çdo dokument tjetër, dhe në ndryshimin, krijimin, menaxhimin, ekzekutimin dhe realizimin e një garancie për Huan. Banka do të sigurojë dokumente mbështetëse për çdo detyrim ose shpenzim të tillë 14 (katëmbëdhjetë) ditë para se kërkesa e tij për pagesë të bëhet e kërkueshme, me përjashtim të detyrimeve dhe shpenzimeve të vogla (kryesisht të lidhura me detyrime të mundshme bankare të aplikueshme për disbursimet) të lidhura me shumata deri në 50 euro (pesëdhjetë euro) për të cilat Banka do të sigurojë menjëherë dokumente mbështetëse me kërkesë të Huamarrësit.

9.03 Kostoja e shtuar, zhdëmtimi dhe *set-off*

a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës çdo shumë ose shpenzim që shkaktohet ose pësohet nga Banka si pasojë e paraqitjes së një ndryshimi në (ose në interpretimin, administrimin apo zbatimin e) një ligji apo rregulloreje apo përmbushjeje me çdo ligj ose rregullore të bërë pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate, në pajtim me ose si rezultat i të cilit: (i) Banka është e detyruar të bëjë shpenzime shtesë me qëllim që të financojë ose përmbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate; ose (ii) çdo shumë e huazuar Bankës sipas kësaj Kontrate ose të ardhurat financiare që rezultojnë nga dhënia e Kredisë ose Huas nga Banka Huamarrësit ulet ose eliminohet.

b) Pa cenuar asnjë të drejtë tjetër të Bankës sipas kësaj Kontrate ose sipas një ligji të zbatueshëm, Huamarrësi do të zhdëmtojë dhe mbajë Bankën të padëmtuar nga dhe kundrejt çdo humbjeje të shkaktuar si rezultat i një pagese ose shlyerjeje të pjesshme që bëhet në një mënyrë të ndryshme nga sa është parashikuar shprehimisht në këtë Kontratë.

c) Banka mund të kompensojë çdo detyrim të maturuar të kërkueshëm nga Huamarrësi sipas kësaj Kontrate (në masën që është në pronësi të Bankës) ndaj çdo detyrimi (i maturuar ose jo) që Banka i huazon Huamarrësit pavarësisht nga vendi i pagesës, degës së porosisë ose monedhës së një detyrimi të



caktuar. Nëse detyrimet janë në monedha të ndryshme, Banka mund të konvertojë secilin detyrim me normën e këmbimit të tregut në ushtrim normal të aktivitetit për qëllimin e kompensimit. Nëse një detyrim është i palikuiduar apo i pakonfirmuar, Banka mund të kryejë kompensimin në një shumë të vlerësuar prej saj në mirëbesim që është shuma e detyrimit.

Neni 10

Raste të mosplotësimit të detyrimeve

10.01 E drejta për të kërkuar shlyerje

Huamarrësi do të shlyejë të gjithë ose një pjesë të Huas (siç kërkohet nga Banka) menjëherë, së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të mbledhura dhe të pashlyera sipas kësaj Kontrate, me kërkesë me shkrim që bëhet nga Banka në pajtim me dispozitat e mëposhtme.

10.01A Kërkesa e menjëhershme

Banka mund të bëjë një kërkesë të tillë menjëherë:

a) nëse Huamarrësi nuk paguan në datën e kërkuar një shumë të pagueshme në pajtim me këtë Kontratë në vendin dhe në monedhën në të cilën deklarohet që është e pagueshme, përveç kur: (i) mospagimi shkaktohet nga një gabim administrativ ose teknik ose një Ngjarje Ndërprerjeje; dhe (ii) pagesa bëhet brenda 3 Ditëve Pune nga data e kërkueshme;

b) nëse çdo dokument ose informacion i dhënë Bankës nga ose në emër të Huamarrësit ose çdo përfaqësim, garanci apo deklarim e bërë ose menduar të jetë bërë nga Huamarrësi në ose në pajtim me këtë Kontratë është ose vërtetohet të jetë e pasaktë, e paplotë ose e gabuar në një aspekt material;

c) nëse, pas çdo mospërbushjeje të Huamarrësit në lidhje me çdo hua, ose çdo detyrim që rrjedh nga çdo transaksion financiar, i ndryshëm nga Huaja:

(i) Huamarrësit i kërkohet ose është në gjendje t'i kërkohet, ose, pas skadimit të çdo periudhe pa pagesë principali të zbatueshme kontraktuale, i kërkohet ose është në gjendje t'i kërkohet të parapaguajë, të shlyejë, të mbyllë ose të zgjidhë para maturimit një hua ose detyrim tjetër; ose

(ii) çdo angazhim financiar për një hua ose detyrim tjetër anulohet ose pezullohet;

d) nëse Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë detyrimet e tij kur ato bëhen të kërkueshme, ose pezullon borxhet e tij, ose merr apo kërkon të marrë një masë ose marrëveshje me kreditorët e tij;

e) nëse një procedim gjyqësor apo procedurë tjetër apo hap ndërmerret në lidhje me pezullimin e

pagesave, një moratorium i qenies në borxh, duke përfshirë veçanërisht, pezullimin e pagesave (*sursis de paiement*) ose një procedurë ose hap i ngjashëm ndërmerret në një juridiksion;

f) nëse një mbajtës i garancisë merr në zotërim ose një marrës, administrator, likuidator administrues ose nëpunës i ngjashëm caktohet, nga një gjykatë me juridiksion kompetent ose nga një autoritet kompetent administrativ ose nga një person, për ose mbi, një pjesë të sendeve pasurore të Huamarrësit ose një pjesë që përbën pjesë të Projektit;

g) nëse Huamarrësi është në mosplotësim të përmbushjes së çdo detyrimi në lidhje me çdo hua tjetër të garantuar nga Banka ose një instrument financiar të lidhur me Bankën;

h) nëse Huamarrësi është në mosplotësim të përmbushjes së çdo detyrimi në lidhje me çdo hua tjetër të dhënë nga burimet e Bankës ose Bashkimit Europian;

(i) në qoftë se, pas një mosplotësimi të Huamarrësit në ekzekutimin e ndonjë detyrimi në lidhje me çdo hua apo grant përmendur në paragrafin hyrës (2) ose ndonjë grant tjetër të dhënë atij nga Bashkimi Evropian, e drejta e Huamarrësit për tërheqje të shumave nga ajo hua apo ky grant do të, në tërësi ose pjesërisht, jenë anuluar ose përfunduar ose nëse kjo kredi apo ky grant do të janë bërë të pagueshëm në pajtim me kushtet e saj;

j) nëse një bllokim, ekzekutim, sekuestrim apo proces tjetër vendoset ose zbatohet mbi pronën e Huamarrësit apo çdo pronë që është pjesë e Projektit dhe nuk lirohet ose ndalohet brenda 14 (katërmbëdhjetë) ditëve;

k) nëse ndodh një Ndryshim Material i Pafavorshëm, krahasuar me gjendjen e Huamarrësit në datën e kësaj Kontrate; ose

l) nëse është ose bëhet e paligjshme për Huamarrësin të përmbushë një prej detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate ose kjo Kontratë nuk është në fuqi në pajtim me kushtet e saj ose pretendohet nga Huamarrësi të mos jetë në fuqi sipas kushteve të saj,

10.01B Kërkesa pas njoftimit të korrigjimit

Banka mund të bëjë një kërkesë të tillë:

a) nëse Banka nuk përmbush një nga detyrimet sipas kësaj Kontrate që nuk është detyrim i përmendur në nenin 10.01A; ose

b) nëse ndonjë fakt në lidhje me Huamarrësin ose Projektin i shprehur në paragrafët hyrës ndryshon në masë të konsiderueshme dhe nuk rivendoset në masë të konsiderueshme dhe nëse ndryshimi cenon



interesat e Bankës si huadhënës për Huamarrësin ose ndikon negativisht në zbatimin ose operimin e Projektit,

përveç kur mospërputhja ose rrethana që shkakton mospërputhjen është e mundshme të korrigohet dhe korrigohet brenda një afati kohor të arsyeshëm të përcaktuar në një njoftim drejtuar nga Banka Huamarrësit.

10.02 Të drejta të tjera ligjore

Neni 10.01 nuk kufizon asnjë të drejtë tjetër të Bankës sipas ligjit për të kërkuar parapagimin e Huas.

10.03 Zhdëmtimi

10.03A Transhe me normë fikse

Në rastin e një kërkesë sipas nenit 10.01 në lidhje me një Transh me Normë Fikse, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar së bashku me Zhdëmtimin e Parapagimit për çdo shumë principali që kërkohet të parapaguhet. Ky Zhdëmtim Parapagimi mbledhet nga data e kërkueshme e pagesës e specifikuar në njoftimin e Bankës për kërkesën dhe llogaritet mbi bazën që parapagimi është në fuqi në datën e specifikuar.

10.03B Transhe me Normë të Ndryshueshme

Në rastin e kërkesës sipas nenit 10.01 në lidhje me një Transh me Normë të Ndryshueshme, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës shumën e kërkuar së bashku me një shumë të barabartë me vlerën e tashme të 0.15% (pesëmbëdhjetë pikë bazë) në vit të llogaritur dhe që mbledhet për shumën e principalit që kërkohet të parapaguhet në të njëjtën mënyrë si dhe do të ishte llogaritur dhe mbledhur interesi, nëse kjo shumë ka mbetur e papaguar sipas tabelës fillestare të amortizimit të Transhit, deri në Datën Maturimit.

Vlera do të llogaritet me një normë zbritjeje të barabartë me Normën e Riaktivizimit, të zbatuar në çdo Datë përkatëse të Pagesës.

10.03C Të përgjithshme

Shumat e kërkueshme nga Huamarrësi në pajtim me këtë nen 10.03 do të jenë të pagueshme në datën e parapagimit të përcaktuar në kërkesën e Bankës.

10.04 Mosheqja dorë

Asnjë mosushtrim apo vonesë ose ushtrim i vetëm apo i pjesëshëm nga Banka në ushtrimin e një prej të drejtave të saj ose mjeteve mbrojtëse sipas kësaj Kontrate nuk do të interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë ose mjet mbrojtës. Të drejtat dhe mjetet mbrojtëse të parashikuara në këtë Kontratë janë kumulative dhe nuk janë përjashtuese për të drejtat dhe mjetet e parashikuara me ligj.

Neni 11

Ligji dhe juridiksioni, të ndryshme

11.01 Ligji i zbatueshëm

Kjo Kontratë dhe çdo detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me të do të rregullohet nga ligjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

11.02 Juridiksioni

a) Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European ka juridiksion ekskluziv për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje (“Mosmarrëveshja”) që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Kontratë (duke përfshirë një mosmarrëveshje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose prishjen e kësaj Kontrate apo pasojat e pavlefshmërisë së saj) ose çdo detyrim jokontraktual që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Kontratë.

b) Palët bien dakord që Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European është gjykata më e përshtatshme dhe e duhur për të zgjidhur Mosmarrëveshjet ndërmjet tyre dhe, për pasojë, që ata nuk do të argumentojnë të kundërtën.

c) Palët e kësaj Kontrate heqin dorë nga çdo imunitet ose e drejtë për të kundërshtuar juridiksionin e Gjykatës. Çdo vendim i gjykatave i dhënë në pajtim me këtë Nen do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët pa kufizim ose rezervë.

11.03 Vendi i përmbyshjes

Përveç kur bihet shprehimisht ndryshe dakord me shkrim me Bankën, vendi i përmbyshjes sipas kësaj Kontrate (përveç se në lidhje me detyrimet e Huamarrësit të përcaktuara në nenin 6 të kësaj Kontrate) do të jetë selia e Bankës.

11.04 Prova e shumave të kërkueshme

Në çdo padi ligjore që rrjedh nga kjo Kontratë certifikata e Bankës në lidhje me një shumë ose normë të kërkueshme nga Banka sipas kësaj Kontrate, përveç kur ka gabime të dukshme, do të shërbejë si provë *prima facie* për këtë shumë ose normë.

11.05 Tërësia e Marrëveshjes

Kjo Kontratë përbën të gjithë marrëveshjen ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit në lidhje me dhënien e Kredisë sipas kësaj, dhe ka përparësi ndaj çdo marrëveshjeje të mëparshme, të shprehur ose të nënkuptuar për të njëjtën çështje.

11.06 Pavlefshmëria e pjesëshme

Nëse në një moment ndonjë kusht i kësaj Kontrate është ose bëhet i paligjshëm, i pavlefshëm ose i paekzekutueshëm në një aspekt, ose kjo



Kontratë është ose bëhet e paefektshme në një aspekt, sipas ligjeve të çdo juridiksioni, kjo paligjshmëri, pavlefshmëri, paekzekutueshmëri ose mungesë efektiviteti nuk ndikon:

a) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë në atë juridiksion të çdo termi tjetër të kësaj Kontrate ose efektivitetin e një aspekti tjetër të kësaj Kontrate në atë juridiksion; ose

b) ligjshmërinë, vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë në juridiksione të tjera të atij ose kushteve të tjera të kësaj Kontrate ose fuqinë e kësaj Kontrate sipas ligjeve të këtyre juridiksioneve të tjera.

11.07 Ndryshimet

Çdo ndryshim në këtë Kontratë do të bihet dakord me shkrim ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit.

11.08 Kopjet

Kjo Kontratë mund të nënshkruhet në çdo numër kopjesh, ku të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të vetmin instrument. Çdo kopje është një origjinal, por të gjitha kopjet së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtin instrument.

11.09 Ndryshimet tek palët

Përfituesi nuk mund të kalojë ose transferojë një të drejtë ose detyrim sipas kësaj Kontrate pa pëlqimin e mëparshëm me shkrim të Bankës.

Banka nuk mund të kalojë ose transferojë (nëpërmjet rinovimit, bashkimit apo ndryshe), tërësisht ose pjesërisht, ndonjë prej të drejtave, përfitimeve ose detyrimeve sipas kësaj Kontrate, përveç kur (dhe në çdo rast me njoftim paraprak me shkrim drejtuar Huamarrësit):

a) kalimi, rinovimit ose transferimi bëhet në favor të:

- (i) Komisionit të Bashkimit Europian; ose
- (ii) Fondit Europian të Investimeve; ose
- (iii) një institucioni financiar, një agjencie kredie eksporti ose një institucioni zhvillimi shumëpalësh ku Banka (ose Shtetet Anëtare) është aksionere; ose
- (iv) Bankës Qendrore Europiane ose një banke tjetër kombëtare qendrore të një Shteti Anëtar.

b) kalimet ose transferimet bëhen pas ndodhisë së një ngjarjeje sipas nenit 10.01 ose në lidhje me transaksionet e strukturuar financiare.

Huamarrësi jep pëlqimin e tij të revokueshëm për transferimin e të arkëtueshmeve, të drejtave dhe detyrimeve, dhe merr përsipër të pranojë (nëse i kërkohet) transfertën e të arkëtueshmeve siç përcaktohet në sipër.

Neni 12

Dispozita përfundimtare

12.01 Njoftimet drejtuar palëve

Njoftimet dhe komunikimet e tjera të kryera sipas kësaj Kontrate drejtuar palëve në këtë Kontratë do të bëhen në adresën ose numrin e faksit siç tregohet më poshtë ose në atë adresë tjetër ose numër faksi që një palë njofton paraprakisht tjetrën me shkrim:

Për Bankën

Në vëmendje të: Ops A/MA/3 – SI HR W. BALK

100 boulevard *Konrad Adenauer*

L-2950 Luxembourg

Nr. faksi: + 352 4379 67487

Për Huamarrësin:

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë/Shqipëri

Nr. i faksit: +355 4 222 84 94

Kopje për Zbatuesin

Në vëmendje të: Autoriteti Shqiptar i Rrugëve

Ekipi i Zbatimit të Projektit

Drejtori i PIT-it

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit e

Republikës së Shqipërisë

Rr. Sami Frashëri, nr. 33

Tirana/Shqipëri

Nr i faksit: +355 4 2259 898

12.02 Formulari i njoftimit

Çdo njoftim ose komunikim tjetër i bërë sipas kësaj Kontrate duhet të jetë me shkrim.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera, për të cilat në këtë Kontratë parashikohen periudha fikse ose që vetë caktojnë afate detyruese për marrësit, mund të dorëzohen dorazi, letër rekomande ose faks. Këto njoftime dhe komunikime do të konsiderohen të jenë marrë nga pala tjetër në datën e dorëzimit në lidhje me dorëzimin dorazi ose letër rekomande ose me marrjen e transmetimit në lidhje me një faks.

Njoftimet dhe komunikimet e tjera mund të dorëzohen dorazi, me letër të regjistruar ose faks ose, në masën e rënë dakord nga palët me marrëveshje me shkrim, me e-mail ose komunikim tjetër elektronik.

Pa cenuar vlefshmërinë e një njoftimi të dhënë me faks sipas paragrafit të mësipërm, një kopje e çdo njoftimi të dhënë me faks do t'i dërgohet gjithashtu me letër palës tjetër jo më vonë se në Ditën pasuese të Punës.



Njoftimet e lëshuara nga Huamarrësi në pajtim me një dispozitë të kësaj Kontrate, nëse kërkohet nga Banka, do t'i jepen Bankës së bashku me prova të pranueshme për autoritetin e personit ose personave të autorizuar të nënshkruajnë një njoftim të tillë në emër të Huamarrësit dhe modelet e autorizuar të nënshkrimit të këtij ose këtyre personave.

12.03 Paragrafët hyrës dhe skedulët

Paragrafët hyrës dhe skedulët e mëposhtëm përbëjnë pjesë të kësaj Kontrate:

- Skeduli A Përshkrimi teknik dhe raportimi
- Skeduli B Përkufizim i EURIBOR-it
- Skeduli C Formularë për Huamarrësin
- Skeduli D Kushte Paraprake dhe Certifikata të Huamarrësit
- Skeduli E Formularët A/B

Në dëshmi të kësaj palët kanë realizuar nënshkrimin e kësaj Kontrate në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën angleze, ku secila faqe është sigluar përkatësisht, në emër të Bankës dhe në emër të Huamarrësit.

Nënshkruar për dhe në emër të
**KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS
 SË SHQIPËRISË**
 Ministri i Financave
Shkëlqim Cani

Nënshkruar për dhe në emër të
BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE
 Zëvendës-presidenti
Dario Scannapico

SKEDULI A PËRSHKRIMI TEKNIK DHE RAPORTIMI

A.1 Përshkrim Teknik (Neni 6.02)

Qëllimi, vendndodhja

Projekti ka të bëjë me ndërtimin e afërsisht 29 km autostradë 2 x 1 në një gjurmë të re rreth qytetit të

Vlorës që gjendet pranë bregdetit në Shqipërinë e Jugut. Qëllimi është përmirësimi i kohës dhe sigurisë së udhëtimit, veçanërisht për trafikun transit, si dhe për të lehtësuar rëndimin dhe shqetësimet mjedisore në Vlorë.

Përshkrimi

Elementet dhe parametrat kryesorë teknikë të punëve në autostradë janë si më poshtë:

- 2 x 1 korsi prej 3.75 metra secila
- 60-90 km/orë shpejtësi lëvizjeje, 11.5 ton ngarkesë për aks;
- rreth 18 km korsi ngjitëse, me 3.5 metra korsi e ngadaltë dhe 3.25 metra korsi parakalimi;
- 1.5 metra pjesë anësore, përveç kur ka korsi ngjitëse;
- 12 tek bashkimet - T, T dyfishe ose rrethrotullime, duke përfshirë rrethrotullimin për të lidhur fundin e autostradës Levan Vlorë;
- 6 ura (75-160 metra), katër mbi/nënkalime (30-40metra);
- mure mbështetës dhe punë stabilizimi për pjerrësitë;
- masat e sigurisë në rrugë në pajtim me rekomandimet e auditit të pavarur;
- masat e zbutjes mjedisore në pajtim me kërkesat e vendimit mjedisor;

Përfitimi i tokës dhe zhvendosja duhet të financohen nga Huamarrësi në tërësinë e tyre.

Projekti përfshin gjithashtu shërbimet e konsulencës për mbikëqyrjen e punëve, monitorimin dhe auditimin, si dhe asistencën teknike për të mbështetur zbatimin dhe përgatitjen e projektit të ardhshëm.

Kalendari

Ndërtimi i projektit pritet të fillojë në tremujorin e katërt të vitit 2014 me përfundimin brenda S1 2017

A.2 Detyrimet për informacion sipas nenit 8.01(a)

1. Dërgimi i informacionit: caktimi i personit përgjegjës

Informacioni i mëposhtëm duhet t'i dërgohet Bankës në përgjegjësinë e:

Shoqëria	Autoriteti Shqiptar i Rrugëve
Personi i kontaktit:	Z. Dashamir Xhika
Titulli:	Drejtor i Përgjithshëm
Funksioni/departamenti	Drejtor i Përgjithshëm - Zbatimi i Projektit
Adresa:	Rr. Sam Frashëri, Nr. 33, Tirana, Shqipëri
Tel.	+355 4 223 47 89
Faks:	+355 4 222 36 00
Email:	Dashamir.xhika@arrsh.gov.al

Personi(at) e sipër përmendur i kontaktit është (janë) kontakti(et) përgjegjës për momentin. Huamarrësi e informon BEI-n menjëherë në rastin e çdo ndryshimi.



2. Informacion mbi objekte specifike

Huamarrësi do t'i paraqesë, ose do të garantojë që Zbatuesi t'i paraqesë, Bankës informacionin e mëposhtëm jo më vonë se afati i treguar më poshtë.

Dokument/Informacion	Afati
Ekuivalenti i Formularit A/B të Konservimit Natyror nga Autoriteti kompetent Vendimi mjedisor i Autoritetit Kompetent Mendimi i Autoritetit Kompetent për Arkeologji dhe Kulturë Konfirmim që përfundimi i tokës është përfunduar tërësisht	Disbursimi i parë
Prova të pranueshme për Bankën që: Ekipi i Zbatimit të Projektit PIT është funksional Inxhinieri mbikëqyrës është tërësisht i mobilizuar	Secili disbursim
Një plan operimi dhe mirëmbajtjeje për rrugën, i pranueshëm për Bankën	Tre muaj para hapjes
Përditësim vjetor mbi: (i) zbatimin e planit të veprimit të reformës sektoriale; (ii) shpenzimi i mirëmbajtjes së rrugës për vitin e mëparshëm fiskal (iii) buxheti kombëtar i mirëmbajtjes së rrugëve për çdo vit fiskal.	30 prill çdo vit

3. Informacion mbi zbatimin e Projektit

Huamarrësi do t'i paraqesë, ose do të garantojë që Zbatuesi t'i paraqesë, Bankës informacionin e mëposhtëm mbi progresin e projektit gjatë zbatimit jo më vonë se afati i treguar më poshtë.

Dokument/informacion	Afati	Shpeshhtësia e raportimit
- Raport për Progresin e Projektit - Një përditësim i shkurtër mbi përshkrimin teknik, duke shpjeguar shkaqet për ndryshime të konsiderueshme kundrejt objektit fillestar; - Përditësim në ditën e përfundimit të secilit prej komponentëve kryesorë të projektit, duke shpjeguar shkaqet për një vonesë të mundshme; - Përditësim mbi koston e projektit, duke shpjeguar shkaqet për ndonjë rritje të mundshme të koston kundrejt koston së buxhetuar fillimisht; - Përditësim mbi burimet e financimit; - Një përshkrim të çdo çështjeje kryesore me ndikim në mjedis; - Përditësim mbi kërkesën ose përdorimin e projektit dhe komentet; - Çdo çështje e rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo risk i konsiderueshëm që mund të ndikojë në operimin e projektit; - Çdo padi në lidhje me Projektin që mund të jetë në shqyrtim e sipër.	31 dhjetor 30 qershor	Gjashtëmujore

4. Informacion mbi përfundimin e punëve dhe vitin e parë të funksionimit

Huamarrësi do t'i paraqesë ose do të garantojë që Zbatuesi t'i paraqesë Bankës informacionin e mëposhtëm mbi përfundimin e projektit dhe operacionin fillestar jo më vonë se afati i treguar më poshtë.

Nr.	Dokument/informacion	Data e paraqitjes tek Banka
	Raport mbi Përfundimin e Projektit, duke përfshirë:	
5	Një përshkrim të shkurtër për karakteristikat teknike të projektit të përfunduar, duke shpjeguar shkaqet për ndonjë ndryshim të konsiderueshëm;	
6	Datën e përfundimit të secilit prej komponentëve kryesorë të projektit, duke shpjeguar shkaqet për një vonesë të mundshme;	
7	Kostoja finale projektit, duke shpjeguar shkaqet për ndonjë rritje të mundshme të koston kundrejt koston së buxhetuar fillimisht;	
8	Numri i punëve të reja të krijuara nga projektit: punët gjatë zbatimit dhe punët e reja të krijuara të përhershme;	
9	Një përshkrim të çdo çështjeje kryesore me ndikim në mjedis; Përditësim mbi burimet e financimit; Përditësim mbi kërkesën ose përdorimin e projektit dhe komentet;	
10	Çdo çështje e rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo risk i konsiderueshëm që mund të ndikojë në operimin e projektit;	
11	Listën e rrugëve hyrëse në rrugën e projektit të bëra që nuk ishin parashikuar në dokumentet e projektit final;	
12	Auditimi i sigurisë rrugore të fazës 5 në pajtim me parimet e direktivës së BE-së 2008/96/EC	
	Çdo padi në lidhje me Projektin që mund të jetë në shqyrtim e sipër.	



5. Informacioni i kërkuar 3 vjet pas Raportit të Përfundimit të Projektit (vetëm jashtë BE-së) Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës informacionin e mëposhtëm 3 vjet pas raportit të përfundimit të Projektit jo më vonë se afati i fundit i treguar më poshtë.

Dokument/informacion	Data e paraqitjes tek Banka
Raport mbi Përfundimin e Projektit, duke përfshirë: Përditësim mbi vlerat faktike për treguesit e Projektit, për përfshirjen e Matjes së Rezultateve nga Banka (formulari REM) (për rrugët e reja dhe të vjetra: (i) trafiku në AADT sipas kategorive kryesore, (ii) të dhëna mbi aksidentet rrugore).	31 dhjetor 2019
Gjuha e raporteve	Anglisht

SKEDULI B PËRKUFIZIMET E EURIBOR-IT DHE LIBOR-IT

A. EURIBOR-i

“EURIBOR-i” është:

a) në lidhje me një periudhë përkatëse prej më pak se një muaj, Normën e Kontrollit (siç është përkufizuar më poshtë) për një afat prej një muaj;

b) në lidhje me një periudhë përkatëse prej një ose më shumë muaj për të cilën është e disponueshme një Normë Kontrolli, Norma e zbatueshme e Kontrollit për një afat për numrin korrespondues të muajve; dhe

c) në lidhje me një periudhë përkatëse prej më shumë se një muaj për të cilën nuk është e disponueshme një Normë Kontrolli, norma që rezulton nga një interpolim linear duke iu referuar dy Normave të Kontrollit, një prej të cilave është e zbatueshme për një periudhë më të shkurtër dhe tjetra për një periudhë më të gjatë se gjatësia e periudhës përkatëse, (periudha për të cilën merret norma ose nga e cila normat interpolohen është “Periudha Përfaqësuese”).

Për synimet e paragrafëve (b) dhe (c) më sipër, “e disponueshme” është “e llogaritur dhe e publikuar” nën kujdesin e EURIBOR EBF dhe EURIBOR ACI (ose çdo pasues për këtë funksion të EURIBOR EBF dhe EURIBOR ACI që përcaktohet nga Banka) për maturimet e dhëna. “Normë Kontrolli” është norma e interesit për depozitat në euro për periudhën përkatëse që publikohet në orën 11 00 sipas orës së Brukselit ose në një orë të mëvonshme të pranueshme për Bankën në ditën (“Dita e Rivendosjes”) që bie 2 (dy) Ditë Pune Përkatëse para ditës së parë të periudhës përkatëse, në faqen e Reuters EURIBOR 01 ose faqen pasuese të tij ose, në mungesë të saj, me çdo mjet tjetër publikimi të zgjedhura për këtë qëllim nga Banka.

Nëse një normë e tillë nuk shpallet, Banka u kërkon zyrove kryesore të uuros të katër bankave

kryesore në eurozonë, të zgjedhur nga Banka, për të kuotuar normën në të cilën ofrohen depozitat në euro në një shumë të krahasueshme nga secila prej tyre, afërsisht në orën 11.00 me orën e Brukselit në Datën e Rivendosjes, në bankat kryesore në tregun ndërbankar të Eurozonës për një periudhë të barabartë me Periudhën Përfaqësuese. Nëse jepen të paktën 2 (dy) kuotime, norma për Datën e Rivendosjes do të jetë shuma matematikore e kuotimeve të dhëna.

Nëse jepen më pak se 2 (dy) kuotime siç kërkohen, norma për atë Data Rivendosjeje do të jetë mesatarja aritmetike e normave të kuotuar nga bankat kryesore në Euro-zonë, të zgjedhur nga Banka, në afërsisht orën 11 00, sipas orës së Brukselit, në ditën që bie 2 (dy) Ditë Përkatëse Pune pas Datës së Rivendosjes, për huatë në euro në një shumë të krahasueshme me Bankat kryesore europiane për një periudhë të barabartë me Periudhën Përfaqësuese.

Nëse norma që rezulton sa më sipër është nën zero, EURIBOR-i konsiderohet të jetë zero.

Nëse nuk jepet asnjë normë interesi sipas parashikimit të mësipërm, EURIBOR-i është norma (e shprehur si normë përqindjeje në vit) që përcaktohet nga Banka të jetë kostoja e plotë për Bankën për fondin e Transhit përkatës bazuar në normën e zbatueshme të referencës të Bankës që gjenerohet brendapërbrenda ose metodë alternative për përcaktimin e normës të përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga Banka.

B. TË PËRGJITHSHME

Për qëllimet e përkufizimeve të mësipërme:

a) Të gjitha përqindjet që rrjedhin nga llogaritjet e referuara në këtë Grafik do të rumbullakohen, sipas rastit, në shifrën njëqind për mijë më të afërt të pikës së përqindjes, ku gjysmat rumbullakohen.

b) Banka njofton Huamarrësin pa vonesë për kuotimet e marra nga Banka.

